

Raport Nr.

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim

INSP/49504-AL

**RAPORT DHE REKOMANDIM I EKIPIT DREJTUES
NË PËRGJIGJE TË
RAPORTIT TË INVESTIGIMIT TË PANELIT TË INSPEKTIMIT**

SHQIPËRIA:

**PROJEKTI PËR PRODHIMIN DHE RISTRUKTURIMIN E SEKTORIT TË
ENERGJISË**

(Kredi nga SHNZH, Nr. 3872-ALB)

18 shtator 2009

**RAPORT DHE REKOMANDIM I EKIPIT DREJTUES
NË PËRGJIGJE TË RAPORTIT TË INVESTIGIMIT TË PANELIT TË
INSPEKTIMIT
NË LIDHJE ME
SHQIPËRIA: PROJEKTI PËR PRODHIMIN DHE RISTRUKTURIMIN E
SEKTORIT TË ENERGJISË (Kredi e SHNZH-së, Nr 3872-ALB)**

1. Në mbështetje të paragrafit 23 të Rezolutës që krijon Panelin e Inspektimit (Rezoluta e BNRZH-së Nr 93-10 dhe Rezoluta e SHNZH-së Nr 93-6), bashkëlidhur, i paraqitet për shqyrtim Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë Raporti dhe Rekomandimi i Ekipit Drejtues, në përgjigje të konstatimeve të parashtruara në Raportin e Investigimit Nr 49504-AL, i datës 7 gusht 2009, i Panelit të Inspektimit, në lidhje me projektin e cituar në titull (Shqipëria: Projekti për Prodhimin dhe Ristrukturimin e Sektorit të Energjisë” (Kredi e SHNZH-së Nr 3872-ALB)).

**RAPORT DHE REKOMANDIM I EKIPIT DREJTUES
NË PËRGJIGJE TË
RAPORTIT TË INVESTIGIMIT TË PANELIT TË INSPEKTIMIT, NR 49504-AL**

**SHQIPËRIA:
PROJEKTI PËR PRODHIMIN DHE RISTRUKTURIMIN E SEKTORIT TË
ENERGJISË (Kredi e SHNZH-së, Nr 3872-ALB)**

PËRMBAJTJA

Shkurtime	iv
Shkurtime	iv
Lista e Politikave Operative dhe Deklaratave të Manualeve të Punës.....	v
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	vi
I. HYRJE	1
II. Konteksti dhe statusi i Projektit	1
Konteksti	1
Projekti	3
Statusi i Projektit.....	5
III. Çështjet kyçe	7
Zbatimi i kërkesave mjedisore	7
Konsultimet, Pjesëmarrja dhe Dhënia e Informacionit.....	20
IV. plani i veprimit i ekipit drejtues NË PËRGJIGJE TË konstatimeve	25
V. Përfundim.....	27

Kutitë

Kutia 1:	Përgjigje ndaj komenteve të Panelit lidhur me “Kërcënimin për pezullim”
Kutia 2:	Modelim i përditësuar i çlirimeve atmosferike
Kutia 3:	Vendndodhja e TEC-it

Anekset

Aneksi 1:	Konstatime, komente dhe veprime
Aneksi 2:	Modelimi i çlirimeve atmosferike (Përditësim i Raportit të Ecurisë Mjedisore nga KESH-i, gusht 2009, Rubrika 3 “Cilësia e ajrit”)
Aneksi 3:	Fotografitë

Harta

Harta 1.	IBRD 37154, Projekti i Prodhimit dhe Ristrukturimit të Sektorit të Energjisë në Shqipëri, Zona e Projektit në Vlorë
----------	---

SHKURTIME

PB	procedurat e bankës
CCGT	turbinë gazi me cikël të kombinuar
CIDA	Agjensia Kanadeze për Zhvillimin Ndërkombëtar
VM	Vlerësimi Mjedisor
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
EAQ	Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore
ECSIE	Njësia e Sektorit të Energjisë dhe Infrastrukturës për EAQ-në
ECSSD	Njësia e Zhvillimit të Qendrueshëm Mjedisor dhe Social për EAQ-në
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
PAM	plani i administrimit mjedisor
NJAM	njësi e administrimit mjedisor
PPN	projektimi, prokurimi dhe ndërtimi
BE	Bashkimi Evropian
CARDS BE	Programi i BE-së për Asistencën e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
EUR	euro
GWh	gigavatorë
SHNZH	Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
FZHI	Fondi për Zhvillimin Institucional
IFN	institucionet financiare ndërkombëtare
PIN	Paneli i Inspektimit
IPPC	Direktiva e BE-së “Për ndotjen e integruar dhe parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll”
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare.
kWh	kilovatorë
MW	megavat
OJQ	organizatë jo qeveritare
DMP	Deklarata e Manualit të Punës
PO	politikë operative
NPO	notë e politikave operative
DIP	dokument i informacionit të projektit
TEC	termocentral
UCTE	Unioni për Bashkërendimin e Transmetimit të Energjisë Elektrike
UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjensia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve
USD	dollari amerikan
USTDA	Agjensia për Tregti dhe Zhvillim e SHBA-ve

Njësia valutore

(deri më 16 shtator 2009)

1 lek = 0,0107 USD / 1 USD = 93,14 lekë

1 EUR = 1,46 USD / 1 USD = 0,68 EUR

LISTA E POLITIKAVE OPERATIVE DHE DEKLARATAVE TË MANUALEVE TË PUNËS

DMP 2.20	Vlerësimi i Projekteve
PO/PB 4.01	Vlerësimi Mjedisor
PO/PB 4.04	Habitatet Natyrore
PO/PB 10.04	Vlerësimi Ekonomik i Operacioneve të Investimeve
NPO 11.03	Administrimi i Pasurive Kulturore në Projektet e Financuara nga Banka
PO/PB 13.05	Mbikëqyrja e Projekteve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Informacion i shkurtër shpjegues

1. Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë është prekur negativisht nga mungesat e energjisë elektrike. Kjo është theksuar gjithmonë, si një pengesë madhore për biznesin. Për më tepër, nevojat e Shqipërisë për energji elektrike plotësohet thuajse vetëm nga sektori hidroenergjetik, i cili vuan gjatë thatësirës. Kriza e energjisë elektrike ka ndikuar shumë në jetën e shqiptarëve. Së pari, ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të energjisë elektrike i privojnë njerëzit nga drita, ngrohja e ambienteve, ftohja e ushqimeve dhe mundësia për të gatuar, duke ndikuar, kështu, negativisht në cilësinë e jetës dhe në shëndetin e tyre, si edhe duke penguar arsimin e tyre. Së dyti, importet e shtrenjta të energjisë elektrike e kanë rritur nevojën për subvencione nga qeveria, duke i larguar, kështu, burimet nga puna për uljen e varfërisë. Së treti, kriza e prek negativisht rritjen ekonomike, duke e penguar punën për uljen e varfërisë. Në kushtet ku klima në Shqipëri parashikohet të jetë ndjeshëm më e ngrohtë dhe më e thatë në dekadat në vijim, ka të ngjarë që sektori hidroenergjetik të përballet me kufizime të mëtejshme.

2. Projekti do të përdorë një teknologji me turbinë gazi me cikël të kombinuar (CCGT), e cila arrin një rendiment ndjeshëm më të lartë se alternativat e tjera për prodhimin e energjisë në termocentrale dhe ka çlirime shumë të ulëta atmosferike. Në periudhën afatshkurtër deri afatmesme, centrali do të përdorë naftë me përmbajtje të ulët squfuri. Specifikimet e lëndës djegëse për centralin parashikojnë naftë me përmbajtje të ulët squfuri, në mënyrë që të zvogëlohen çlirimet, edhe pse kjo do t'i rrisë kostot e shfrytëzimit. TEC-i është projektuar që të lejojë konvertimin e tij në impiant me gaz natyror, i cili është edhe më i pastër, nëse do të importohet dhe kur të importohet gazi në Shqipëri.

3. Si rezultat, në fillim të vitit 2002, në përgjigje të një kërkesë nga Qeveria, Banka ra dakord të punojë për të siguruar mbështetje nga institucionet financiare ndërkombëtare për një termocentral të ri. Në janar 2003, filloi përgatitja e projektit për një termocentral 100 MW në një truall në një zonë industriale pranë Vlorës¹, i përzgjedhur nga Qeveria, pas një studimi për vendndodhjen i cili studionte gjashtë alternativa. Projekti u aprovua nga Bordi në prill 2004 dhe filloi në janar 2005. Banka Botërore jep një kredi nga SHNZH-ja me vlerë 25 milion USD, ose diçka më shumë se 20 për qind e kostos gjithsej të Projektit, prej 123,3 milion USD. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Evropiane e Investimeve japin secila rreth 44 për qind të financimit gjithsej, ndërsa pjesën tjetër e mbulon Qeveria e Shqipërisë. Punët civile për Projektin filluan në gusht 2007, ndërsa centrali është tani në fazat e fundit të ndërtimit, ku shfrytëzimi pritet të fillojë përpara fundit të vitit 2009.

Çështjet përpara Panelit të Inspektimit

¹ Sipas metodës së ndjekur në Raportin e Investigimit, në versionin anglisht të raportit emri “Vlora” shpesh shkruhet edhe “Vlore” dhe “Vlorë”. Të tri mënyrat e shkrimit janë të përkëmbeshme dhe nuk ka asnjë dallim midis tyre.

4. Në maj të vitit 2007, Paneli i Inspektimit regjistroi një Kërkesë për Inspektim lidhur me Projektin e Prodhimit dhe Ristrukturimit të Sektorit të Energjisë në Shqipëri, të cilën e kishte paraqitur Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës, në emër të banorëve të Vlorës. Kërkuesit argumentonin se projekti do ta “shkatërrojë në mënyrë të pakthyeshme mjedisin, turizmin, peshkimin e sigurt, habitatin natyror, kolonitë e koraleve, si edhe rëndësinë e pashoqe historike dhe kulturore të gjithë Gjirit të Vlorës dhe Lagunës së Nartës.” Kërkuesit shprehnin një sërë shqetësimesh lidhur me zbatimin e politikave operative të Bankës nga ana e saj. Më 1 qershor 2007, Ekipi Drejtues iu përgjigj pretendimeve të ngritura në Kërkesë. Në Raportin që i paraqiti Bordit, më pas, Paneli konstatoi se Kërkesa i plotësonte kushtet dhe u rekomandonte Drejtorëve Ekzekutivë të lejonin një investigim. Kjo është autorizuar më 18 korrik 2007, ndërsa më 7 gusht 2009 Paneli nxori raportin e tij me konstatimet e investigimit.

5. Ekipi Drejtues i është mirënjohës Panelit për paraqitjen e qartë dhe të plotë të konstatimeve. Ekipi Drejtues e vlerëson, sidomos, faktin që Paneli ka arritur në përfundimin se centrali nuk do t’i kalojë kufijtë maksimalë për çlirimet atmosferike dhe shkarkimet e ujit ftohës; se nuk do ta prekë negativisht Lagunën e Nartës; dhe se nuk ka sjellë dëmtimin apo shkatërrimin e trashëgimisë kulturore apo të habitateve natyrore me rëndësi kritike. Ekipi Drejtues vlerëson edhe konfirmimin e Panelit që është përzgjedhur zgjidhja teknike e duhur. Në këtë kuadër, Ekipi Drejtues beson se duhet lëvdur Qeveria e Shqipërisë që ka përzgjedhur zgjidhjen teknike më të pranueshme nga ana mjedisore për një termocentral, ku gërshetohet një teknologji prodhimi me rendiment të lartë, me çlirime të parashikuara që janë shumë më poshtë se standardet e Bashkimit Evropian.

6. Ekipi Drejtues pajtohet tërësisht me përfundimin e Panelit se rreziku madhor i mbetur i lidhur me centralin ka të bëjë me rrjedhje të mundshme të naftës nga furnizimi i centralit me naftë, mirëpo sqaron në raport se kjo po trajtohet tërësisht. Ekipi Drejtues i pranon edhe shqetësimet e Panelit lidhur me procesin e konsultimeve të zhvilluar nga Qeveria e Shqipërisë për centralin dhe investimet e tjera në zonën e Vlorës, të cilat sollën një konstatim negativ kundër Shqipërisë nga ana e Komitetit të Zbatimit të Konventës së Arhusit. Banka nuk është palë e Konventës, mirëpo mangësi të tilla në lirinë e informimit gjatë procesit të vendimmarrjes të Qeverisë kanë rrjedhojat e tyre për efektivitetin e zbatimit të politikave operative të Bankës. Si rrjedhojë e gjykimit të Komitetit të Arhusit, Banka dhe institucionet financiare ndërkombëtare të tjera e pranojnë se janë të nevojshme udhëzime dhe trajnim i mëtejshëm për stafin. Banka është konsultuar lidhur me këtë me Komitetin e Zbatimit dhe Shqipëria po zbaton planin e vet të veprimit për të përmirësuar zbatimin e Konventës së Arhusit, i cili, pjesërisht, mbështetet me fonde të Bankës.

7. Paneli ka ngritur një sërë shqetësimesh lidhur me cilësinë e përgatitjes së projektit, sidomos të procesit të vlerësimit mjedisor (VM). Një shqetësim është përdorimi nga ana e Qeverisë së Shqipërisë i të njëjtëve konsulentë të huaj për VM-në dhe për studimet e realizueshmërisë dhe të vendndodhjes. Ekipi Drejtues pajtohet me Panelin se është e dëshirueshme të ketë mbështetje inxhinjrike më vete nga mbështetja për VM-në dhe se kjo është norma për shumicën e projekteve të Bankës të klasifikuar si Kategori A. Në rastin e këtij projekti, u ndoq një qasje alternative e Bankës, në të cilën, për të shqyrtuar dokumentet dhe për të dhënë rekomandime për kontrollin e cilësisë, u zgjodh një firmë e pavarur me përvojë në sektorin përkatës, por pa lidhje me firmën që përgatiti

VM-në. Rekomandimet e shqyrtuesit të pavarur u morën në konsideratë për ta përmirësuar VM-në përfundimtar.

8. Një shqetësim i dytë ishte përqendrimi i vëmendjes së Bankës te çështjet specifike të projektit pas përzgjedhjes së vendndodhjes, pa e zgjeruar vëmendjen te çështjet e gjera të zhvillimit sektorial dhe strategjik. Ekipi Drejtues beson se nuk kërkohej një qasje VM-je sektoriale apo strategjike për të qenë konform politikës së Bankës, sidomos po të kemi parasysh mungesën e lidhjeve financiare apo ekonomike dhe natyrën e pakonfirmuar të investimeve të tilla. Ekipi Drejtues e pranon se mbulimi në VM i efekteve nga njësitë shtesë të centralit (deri në një maksimum prej 300 MW) ishte i paqartë. Ekipi Drejtues sqaron se, ndërkohë që studimet e realizueshmërisë dhe të vendndodhjes të kryer nga Qeveria e Shqipërisë e shqyrtonin këtë mundësi të zgjerimit të centralit, Banka dhe bashkëfinancuesit e saj mendonin se mundësia financiare e njëjësive shtesë në periudhën afatshkurtër deri afatmesme ishte shumë e ulët. Ekipi Drejtues vëren se ky qëndrim vlen ende edhe sot, pas tetë vjetësh. Megjithatë, Ekipi Drejtues vëren se analizat mjedisore të përditësuara tregojnë se edhe në rastin e centralit me kapacitet 300 MW do të përmbusheshin standardet e Bashkimit Evropian për ajrin dhe ujin termik. Ekipi Drejtues e jep këndvështrimin e vet në Raport për këto dhe për argumente të tjera. Në të njëjtën kohë, ai pranon disa mangësi në VM, në konsultime dhe në analizën e rreziqeve sociale.

9. Mirëpo, Paneli pranon edhe se centrali është ndërtuar tani dhe se vëmendja duhet drejtuar nga shfrytëzimi i tij në të ardhmen. Ekipi Drejtues pajtohet me Panelin lidhur me dy fusha. Njëra ka të bëjë me rrezikun e rrjedhjeve të naftës dhe kjo trajtohet drejtpërdrejt në planin e propozuar të veprimit të Ekipit Drejtues. I dyti ka të bëjë me procesin e përgjithshëm të planifikimit për Gjirin e Vlorës. Lidhur me këtë çështje, Banka, së bashku me donatorë të tjerë, ka punuar nga afër me Qeverinë për hartimin e një ligji për planifikimin e territorit, i cili hedh bazat për të siguruar ndërmarrjen e vlerësimeve të duhura në të ardhmen në të gjithë vendin.

Puna për të ardhmen

10. Ekipi Drejtues do të vijojë të angazhohet me Qeverinë e Shqipërisë për të bërë përmirësime në rregullimin e territorit. Për më tepër, Ekipi Drejtues propozon një plan veprimi i cili përfshin këta komponentë:

- Përqendrimi i punës për të siguruar që Plani i Parandalimit dhe Reagimit ndaj Rrjedhjes së Naftës të jetë në funksionim përpara se të vihet në shfrytëzim centrali;
- Sigurimi që në central të vijojë monitorimi mjedisor i fjalës së fundit dhe që t'i jepet informacion shoqërisë civile;
- Të asistohet Qeveria e Shqipërisë (përmes një granti të Fondit për Zhvillim Institucional) për ta fuqizuar kapacitetin e saj për të zbatuar Konventën e Arhusit lidhur me lirinë e informacionit në vendimmarrjen që ka të bëjë me mjedisin;
- Realizimi i një moduli trajnimi të brendshëm për të siguruar që stafi i Bankës të ketë njohuri të plota për mënyrat se si t'i asistojnë qeveritë partnere për t'i përmbushur detyrimet e tyre në kuadër të traktateve ndërkombëtare, sidomos në kuadër të Konventës së Arhusit dhe konventave të tjera të lidhura me të;

- Të punohet me KESH-in, entin shqiptar të energjisë elektrike, për përgatitjen e programeve afruese me shoqërinë civile; dhe
- Në përputhje me angazhimet e marra më parë në kuadër të Raportit të Panelit për Projektin e Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare në Shqipëri, të fuqizohet kapaciteti i brendshëm për t'i trajtuar në mënyrë të efektshme çështjet e rreziqeve sociale.

I. HYRJE

1. Më 2 maj 2007, Paneli i Inspektimit regjistroi një Kërkesë për Inspektim me numër RQ07/03 (e quajtur më tej në këtë Raport si “Kërkesa”), në lidhje me Projektin “Shqipëria: Projekti për Prodhimin dhe Ristrukturimin e Sektorit të Energjisë” (Kredi e SHNZH-së Nr 3872-ALB), financuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (SHNZH). Kërkesa për Inspektim është paraqitur nga Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës, në emër të banorëve vendas që jetojnë në Vlorë (më tej, e quajtur këtu “Kërkuesit”).

2. Për marrjen e Kërkesës Paneli njoftoi Drejtorët Ekzekutivë dhe Presidentin e SHNZH-së. Më 1 qershor 2007, Ekipi Drejtues iu përgjigj pretendimeve të ngritura në Kërkesë. Në Raportin që i paraqiti Bordit, Paneli konstatoi se Kërkesa i plotësonte kushtet dhe u rekomandonte Drejtorëve Ekzekutivë të lejonin një investigim. Investigimi e mori lejen nga Drejtorët Ekzekutivë më 18 korrik 2007.

3. Më 7 gusht 2009 Paneli nxori raportin e tij me konstatimet e investigimit. Ekipi Drejtues i është mirënjohës Panelit për paraqitjen e qartë dhe të plotë të konstatimeve. Raporti që keni në dorë, i cili u përgjigjet konstatimeve të Panelit, është i organizuar në katër rubrika. Rubrika II jep informacion shpjegues për Projektin. Rubrika III trajton çështjet kyçe, ndërsa në Rubrikën IV paraqitet Plani i Veprimit i Ekipit Drejtues në përgjigje të konstatimeve të Panelit. Në Rubrikën V jepet përfundimi. Konstatimet e Panelit, së bashku me përgjigjet e Ekipit Drejtues, përshkruhen me hollësi në Aneksin 1. Aneksi 2 jep informacion për modelimin e çlirimeve atmosferike. Në Aneksin 3 jepen fotografi të truallit të Projektit dhe të rrethinave.

II. KONTEKSTI DHE STATUSI I PROJEKTIT

KONTEKSTI

4. Shqipëria ka vuajtur nga kufizime të rënda të energjisë elektrike nga vera e vitit 2000 deri në vjeshtën e vitit 2008. Kjo ka ndodhur për shkak të rritjes së shpejtë të kërkesës për energji elektrike dhe për shkak të pasojave të situatës jo të favorshme hidrologjike në sistemin hidroenergjetik shqiptar (95% e sistemit mbështetet te hidroenergjetiku). Duke qenë eksportues deri në vitin 1997, pas këtij viti Shqipërisë i është dashur të importojë sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike (nga 300 GWh në vitin 1998 në 2.700 GWh në vitin 2007 dhe 2.300 GWh në vitin 2008). Përmirësimet e situatës hidrologjike në 2003-2005 dhe 2009 sollën zvogëlim të importeve të energjisë elektrike dhe të ndërprerjeve të energjisë elektrike, mirëpo, në mungesë të kapacitetit të ri termik, prekmëria e ekonomisë shqiptare nga hidrologjia negative ka vazhduar të rritet. Në fund të vitit 2006 dhe thuajse gjatë gjithë vitit 2007 dhe gjashtëmuorit të parë të vitit 2008, në vend ka pasur ndërprerje të konsiderueshme të furnizimit me energji.

5. Kriza e energjisë elektrike ka ndikuar shumë në jetën e shqiptarëve. Së pari, ndërprerjet e shpeshta dhe të zgjatura të energjisë elektrike i privojnë njerëzit nga

ndriçimi, ngrohja e ambienteve, ftohja e ushqimeve dhe mundësia për të gatuar, duke ndikuar, kështu, negativisht në cilësinë e jetës dhe në shëndetin e tyre, si edhe duke penguar arsimin e tyre. Së dyti, importet e shtrenjta të energjisë elektrike e kanë rritur nevojën për subvencione nga qeveria, duke i larguar, kështu, burimet nga puna për uljen e varfërisë. Së treti, kriza e prek negativisht rritjen ekonomike, duke e penguar punën për uljen e varfërisë. Shumica e ndërprerjeve të furnizimit me energji në Shqipëri prekin, në mënyrë shpërpjesëtimore, zonat rurale dhe të varfra të vendit.

6. Kriza e energjisë elektrike e ka prekur ecurinë ekonomike në një sërë mënyrash. Një rënie e prodhimit hidroenergjetik është shkak i drejtpërdrejtë i një rënieje të produktit kombëtar. Importet e energjisë elektrike e rrisin deficitin tregtar të Shqipërisë. Ndërprerja e energjisë elektrike çon në ndërprerje të prodhimit industrial dhe kërkon që ndërmarrjet industriale dhe tregtare të instalojnë gjeneratorë të kushtueshëm rezervë që punojnë me naftë automjetesh. Në Vlerësimin më të fundit të Klimës së Investimeve, botuar në 2008, problemet e energjisë elektrike theksoheshin si një prej dy shqetësimeve më të mëdha të bizneseve të gjithë madhësive dhe llojeve.¹ Ndërprerjet e përhapura të energjisë elektrike gjatë një numri vitesh i kanë shtyrë bizneset dhe familjet të investojnë në gjeneratorë elektrikë të cilët janë të shtrenjtë për t'u shfrytëzuar dhe mirëmbajtur, ndërkohë që përdorimi i zgjatur i tyre, gjatë ndërprerjeve të energjisë, e përkeqëson shumë ndotjen e ajrit dhe zhurmën.

7. Nevojat për energji elektrike të Shqipërisë plotësohen vetëm me prodhim hidroenergjetik, i cili i nënshtrohet një luhatjeje të konsiderueshme duke qenë se varet nga reshjet e shiut. Kapaciteti i instaluar është 1.450 MW, ndërsa prodhimi mesatar gjatë një viti hidrologjik normal është rreth 4.200 GWh, kundrejt kërkesës së tanishme prej rreth 6.800 GWh. Rreth 90 për qind të prodhimit të energjisë elektrike në vend e siguron kaskada e Lumit Drin, me një kapacitet gjithsej të instaluar prej 1.350 MW. Pjesa tjetër, prej 100 MW, e kapaciteti hidroenergjetik vjen nga HEC-e të vegjël në lumenj të tjerë. Problemet që lindin nga vartësia e plotë të sistemi hidroenergjetik në një lumë të vetëm përkeqësohen edhe më tej nga fakti se veprat e prodhimit të energjisë janë përqendruar në veri të vendit, ndërsa shumica e qendrave të ngarkesës ndodhen në qendër dhe në jug. Duke qenë se klima në Shqipëri parashikohet të jetë ndjeshëm më e ngrohtë dhe më e thatë, brenda mesit të këtij shekulli, ka të ngjarë që sektori hidroenergjetik të përballet me kufizime të mëtejshme.

8. Nevojitet kapacitet termoenergjetik vendas, për ta zvogëluar vartësinë të importet, për ta diversifikuar prodhimin në vend dhe për të nxitur një përdorim më me rendiment të kapacitetit ekzistues hidroenergjetik. Një shqyrtim i ofertës dhe kërkesës së energjisë elektrike në Evropën Juglindore (2002-2012),² i financuar nga Banka, arrinte në përfundimin se mungesa e një kapaciteti prodhues të ri mund të çojë në mungesa, ku çmimi i importeve të energjisë elektrike në vendet deficitare të rajonit ka të ngjarë të barazohet ose të bëhet më i madh se kostoja e plotë e energjisë nga centralet e reja. Shtimi i kapacitetit prodhues vendas në Shqipëri do ta zvogëlonte vartësinë e tepruar të

¹ *Ngritja e aftësisë konkurruese në Shqipëri*, Raport i Bankës Botërore Nr 47866-AL, pritet të dalë.

² “Shqyrtim i ofertës dhe kërkesës së energjisë elektrike në Evropën Juglindore”, Banka Botërore, ECSIE, 2003.

importet dhe, për rrjedhojë, do ta ulte prekshmërinë nga ndërprerjet e furnizimit dhe rritjet e çmimeve. Mungesat e energjisë kanë filluar të shfaqen që tani në rajon, ndërsa çmimi i importit të energjisë elektrike është rritur ndjeshëm (çmimi mesatar i importit u rrit nga 4,4 Lek/kWh në vitin 2004 në 9,1 Lek/kWh në 2007 dhe 2008). Sidomos gjatë viteve të thata, Shqipëria përballet me vështirësi të konsiderueshme lidhur me sigurimin e energjisë elektrike të mjaftueshme nga importet.

PROJEKTI

9. Në përgjigje të krizës së sektorit energjetik, Qeveria hartoi një plan veprimi në fund të vitit 2000. Qeveria miratoi edhe një Dokument të Politikës për Sektorin Energjetik në prill 2002, ku parashikoheshin reformat sektoriale që duheshin vënë në zbatim, si edhe Strategjinë Kombëtare të Energjisë në qershor 2003, ku identifikoheshin investimet prioritare, nevojat për financim dhe reformat e nevojshme për sektorin energjetik. Në përputhje me strategjinë që jepet në këto dokumente, Qeveria bëri përpjekje për të gjetur financim për centrale të reja elektrike, në përgjigje të mungesës në rritje të energjisë elektrike. Studime të ndryshme, të realizuara me porosi të Qeverisë, evidentonin qartë se ishte i nevojshëm shtimi i kapacitetit prodhues termoenergjetik vendas. Shtimi i kapacitetit termik do ta përmirësonte sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe, rrjedhimisht, do ta lehtësonte rilidhjen e Shqipërisë me rrjetin evropian.

10. Në janar 2002, Qeveria e Shqipërisë u takua me Drejtorin për Vendin e Bankës Botërore dhe i kërkoi Bankës të asistonte në organizimin e financimit nga donatorët, për një termocentral (TEC) të ri. Duke qenë se Banka Botërore kishte një paketë të kufizuar financimi për Shqipërinë në kuadër të fondeve të SHNZH-së, ajo nisi diskutimet me Bankën Evropiane të Investimeve (BEI) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në lidhje me bashkëfinancimin e një TEC-i dhe informoi Qeverinë se tri institucionet financiare ndërkombëtare (IFN) ishin të gatshme ta ndihmonin për të shtuar kapacitetin prodhues termik aq shumë të nevojshëm (një kapacitet nominal prej rreth 100 MW). Një firmë konsulente e njohur në nivel ndërkombëtar (e kontraktuar nga Qeveria e Shqipërisë qysh në vitin 2001) përgatiti një studim të vendndodhjes dhe realizueshmërisë për Projektin e propozuar, me financim nga Agjencia për Tregti dhe Zhvillim e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USDТА) në vitin 2002. Kjo firmë përgatiti edhe një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor (VNM) të Projektit në vitin 2003. Vlerësimi i Projektit filloi në nëntor 2003.

11. TEC-i i Vlorës është centrali i parë i ri elektrik në Shqipëri në më shumë se 20 vjet. Për këtë TEC të vogël, me kapacitet 97 MW, kontrata u lidh në janar 2007. Centrali pritet të japë rreth 680 GWh në vit (me koeficient shfrytëzimi të kohës rreth 80 për qind). Kur të vihët në punë, pritet të mbulojë rreth 20 për qind të deficitit të ofertës, në një vit hidrologjik mesatar. Ndërtimi i një termocentrali në jug të vendit do t'i ulë humbjet teknike dhe do ta përmirësojë ndjeshëm sigurinë dhe cilësinë e furnizimit në vend, në përgjithësi, dhe në jug, në veçanti, ku ky furnizim, momentalisht, është i dobët.

12. Projekti përbëhet nga:

- (i) Një termocentral me turbinë gazi me cikël të kombinuar që përdor naftë me përmbajtje shumë të ulët squfuri, në një truall prej gjashtë hektarësh rreth 6 kilometra në veri të Vlorës, pranë një terminali të vjetër bregdetar për depozita naftë; dhe
- (ii) Asistencë teknike për:
 - vlerësimin e ofertave, dhënien e kontratës dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit;
 - themelimin e një shoqërie të mbikëqyrrur të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), e cila do të zotërojë dhe shfrytëzojë centralin, përgatitjen e një kontrate për blerjen e energjisë dhe asistencë për prokurimin e shërbimeve të një enti shfrytëzues për një periudhë të parë;
 - studimet ndjekëse që kërkon Plani i Administrimit Mjedisor (PAM);
 - shqyrtimin e mundësisë për të kërkuar oferta për të furnizuar centralin me lëndë djegëse;
 - reformat në sektorin energjetik;
 - vrojtimit me konsumatorët;
 - përmirësimet në mbajtjen në kontroll të inventarit; dhe
 - trajnim për prokurimin dhe administrimin mjedisor.

13. Projekti do të përdorë teknologji CCGT për prodhimin e energjisë. Kjo teknologji arrin një rendiment ndjeshëm më të lartë se alternativat e tjera për prodhimin e energjisë në termocentrale dhe ka çlirime shumë të ulëta atmosferike. Teknologjia CCGT përdoret kryesisht me gaz natyror si lëndë djegëse, mirëpo, në mungesë të gazit natyror në Shqipëri në periudhën afatmesme, centrali do të djegë naftë me përmbajtje të ulët squfuri. Specifikimet e lëndës djegëse për centralin parashikojnë naftë me përmbajtje të ulët squfuri, në mënyrë që të zvogëlohen çlirimet, edhe pse kjo do t'i rrisë kostot e shfrytëzimit. *“Do të monitorohet përmbajtja e squfurit të lëndës djegëse për të siguruar që të jetë më pak ose e barabartë me 0,1 për qind e peshës. Për çdo parti furnizimi, do të merren kampionë dhe do të bëhen analizat.”*³ TEC-i është projektuar që të lejojë konvertimin e tij në impiant me gaz natyror nëse do të importohet dhe kur të importohet gazi në Shqipëri.

14. Vlera gjithsej e financimit për kontratën e TEC-it pritet, hë për hë, të jetë 92 milion euro (afërisht 123,3 milion dollarë amerikanë). Në bazë të kontratës së projektimit, prokurimit dhe ndërtimit (PPN), kostoja e Projektit të termocentralit përfshin: (i) një terminal të depozitave të naftës në det; (ii) një naftësjellës nëndetar; dhe (iii) depozitat e lëndës djegëse. Kjo kosto përfshin edhe 4,4 milion dollarë amerikanë për lidhjen me sistemin shqiptar të transmetimit, në nënstacionin 220/110 kV të Babicës, i cili ndodhet në një largësi prej shtatë kilometrash. Kostoja gjithsej e Projektit përfshin edhe 4,85 milion dollarë amerikanë për asistencë teknike dhe trajnim. Termocentrali do të jetë në pronësi dhe në shfrytëzim të një ndërmarrjeje të themeluar më vete, aksionet e së

³ Nga PAM, që është Aneksi i dokumentit të Kontratës (h), Aneksi 5. Shih tabelën 8.4, faqe 21. Përdorimi i kësaj lënde djegëse me përmbajtje të ulët squfuri do të ishte në përputhje me Direktivën 1999/32/EC të KE-së, e cila do të kërkojë që, duke filluar nga data 1 janar 2008, të gjitha naftat me përmbajtje të ulët squfuri ta pakësojnë përmbajtjen e squfurit në 0,1%.

cilës do të zotërohen nga KESH-i. Do të ketë një kontratë për blerjen e energjisë, midis shoqërisë dhe KESH-it, me pagesë të garantuar për një periudhë të kufizuar.

15. Financimi i Projektit është siguruar përmes një kredie të SHNZH-së me vlerë të barasvlershme 25 milion dollarë amerikanë dhe kredi 40 milion euro secila (përafërsisht 54 milion dollarë amerikanë) nga BEI dhe BERZH-i. Tri IFN-të po japin financim të përbashkët, dhe jo financim paralel, duke qenë se ka një kontratë të vetme furnizimi dhe instalimit (PPN) për TEC-in.

16. Përfitimet e projektit janë: (i) rritje e furnizimit me energji elektrike nga termocentrali i ri, që do të ndihmojë në përmirësimin e bilancit midis energjisë të prodhuar në HEC-e dhe asaj të prodhuar në TEC-e; (ii) evitim i kostove të linjave të transmetimit dhe kondensatorëve për përmirësimin e shërbimit me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut; (iii) ulje të kostove të transmetimit, duke qenë se centrali do të jetë pranë qendrave të kërkesës në Shqipërinë e Jugut, kur ka, tani për tani, mungesa të furnizimit; (iv) potenciali për të plotësuar kushtin për t'u lidhur me sistemin UCTE⁴; (v) më pak ndërprerje të energjisë elektrike si rezultat i zvogëlimit të humbjeve jo teknike dhe përmirësimit të arkëtimit të fatura, duke qenë se të dyja këto çojnë në ulje të kërkesës dhe përmirësim të aftësisë së KESH-it për të paguar energjinë elektrike të importuar; (vi) përmirësim i ecurisë financiare të sektorit energjetik si rezultat i zvogëlimit të humbjeve në transmetim dhe shpërndarje dhe (vii) vënia në zbatim nga ana e Qeverisë, e një strategjie të qartë të reformave në sektorin energjetik. Krahas këtyre, rritja e furnizimit me energji elektrike duhet të ndihmojë në mbështetjen e rritjes së turizmit në zonën e Vlorës si edhe, më tej, në jug.

17. Vënien në zbatim të Projektit e ka administruar KESH-i, me një Njësi Menaxhimi Projekti me përvojë nga projektet e mëparshme energjetike të Bankës në Shqipëri.

STATUSI I PROJEKTIT

18. Projekti u miratua më 16 mars 2004 nga Bordi i Bankës Botërore, dokumentet ligjore u nënshkruan më 6 prill 2004 dhe Projekti hyri në fuqi më 25 janar 2005. Mirëpo, procesi fillestar i prokurimit hasi në vonesa të konsiderueshme, së pari për shkak të kohës së nevojshme për të marrë konfirmimin përfundimtar të Qeverisë për vijimin e Projektit (shih Kutinë 1, më poshtë) dhe, së dyti, për shkak të kompleksitetit të procesit të vlerësimit, duke pasur parasysh nevojën për të krahasuar oferta për njësi të madhësive të ndryshme dhe për të përfshirë edhe efektin e komponentit të propozuar për kontratën e mirëmbajtjes. Si rezultat, kontrata e PPN-së u nënshkrua jo më herët se data 9 shkurt 2007 dhe hyri në fuqi më 5 maj 2007. Projekti teknik i objektit filloi menjëherë pas hyrjes në fuqi të kontratës së PPN-së, ndërsa ndërtimi në truallin e Projektit filloi në gusht 2007.

Kutia 1: Përgjigje ndaj komenteve të Panelit lidhur me “Kërcënimin për pezullim”

Ekipi Drejtues vëren diskutimin e Panelit për ndryshimin e Qeverisë në vitin 2005 dhe letrat e

⁴ Unioni për Bashkërendimin e Transmetimit të Energjisë Elektrike. Vini re që, duke filluar nga data 1 korrik 2009, Rrejt Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike (ENTSO-E) ka marrë detyrat operative të gjithë operatorëve ekzistues të transmetimit të energjisë elektrike në Evropë, përfshirë edhe UCTE.

Ekipit Drejtues drejtuar Qeverisë, në prill dhe maj 2006, në të cilat Banka kërkonte konfirmimin nga Qeveria e re e Shqipërisë se ishte dakord me vijimin e Projektit të Prodhimit dhe Ristrukturimit të Sektorit të Energjisë.

Ekipi Drejtues dëshiron të ritheksojë se, kur ndryshoi Qeveria e Shqipërisë, pas zgjedhjeve të vitit 2005, Banka u dha kohë autoriteteve të reja ta shqyrtonin projektin, duke e ditur se ai kishte qenë objekt i debatit politik dhe fushatës zgjedhore. Madje, Qeveria e re krijoi një komision të posaçëm, i cili bëri dy mbledhje në Tiranë (tetor 2005) dhe një mbledhje të tretë në Vlorë (nëntor 2005) për ta shqyrtuar projektin.

Mirëpo, deri në prill 2006 ende nuk ishin të qarta synimet e Qeverisë. Atëherë, Ekipit Drejtues iu desh të vendoste se çfarë të bënte me Projektin, i cili nuk kishte aktiv për 25 muaj qysh prej miratimit nga Bordi dhe 15 muaj qysh prej fillimit të tij. Duke pasur parasysh vonesat e konsiderueshme gjatë vënies në zbatim dhe shumën e burimeve të vyera të SHNZH-së që ishin angazhuar për një projekt që nuk po bënte përpara, Ekipi Drejtues mendon se ishte gjëja e duhur në atë kohë që t'i kërkohej Qeverisë një angazhim i qartë për ta vijuar projektin apo për ta anuluar atë.

19. Ecuria e kontratës së PPN-së ka hasur në disa vonesa dhe, edhe pse në fillim ishte planifikuar që TEC-i të ishte në shfrytëzim të plotë në qershor 2009, tani pritet t'i kalohet KESH-it për shfrytëzim normal në fillim të muajit nëntor të këtij viti. Deri më 4 shtator 2009, kishin mbaruar rreth 95 për qind e punëve ndërtimore dhe TEC-i është në fazën e vendosjes në punë. Projekti është lëvruar në masën 84 për qind, ndërsa fondet e mbetura të palëvruara janë tërësisht të angazhuara. Data e tanishme e mbylljes së Projektit është 31 dhjetor 2009. Megjithatë, në varësi të ecurisë faktike të kontratës së PPN-së, mund të jetë e nevojshme një shtyrje e datës së mbylljes me disa muaj të tjerë.

20. Misione të rregullta mbikëqyrjeje janë kryer nga ekipi i projektit⁵ pas miratimit të projektit nga Bordi i Bankës Botërore. Mbikëqyrja e Projektit gjatë ndërtimit të TEC-it të Vlorës përfshiu praninë e rregullt në vendndodhje të ekipit të Projektit, ndërsa Ekipi Drejtues Rajonal për Evropën dhe Azinë Qendrore (EAQ) (Nënpresidenti, Drejtori për Vendin, Drejtori Strategjik dhe i Operacioneve dhe Drejtori i Sektorit) e kanë vizituar kantierin e ndërtimit gjatë misioneve të ndryshme në vend.

21. Zhvillimi më i rëndësishëm lidhur me sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri ka qenë privatizimi i suksesshëm i shoqërisë së shpërndarjes së energjisë elektrike në qershor 2009. Në këtë proces kanë qenë të përfshira Korporata Financiare Ndërkombëtare (KFN) dhe Banka Botërore, ku KFN i ka dhënë Qeverisë shërbime këshillimore, ndërsa Banka një Dorëzani të Pjesëshme për Rrezikun. TEC-i i Vlorës ka kontribuar në këtë reformë të suksesshme përmes trajtimit të shqetësimeve të investitorit lidhur me pasjen e energjisë së mjaftueshme në vend.

⁵ Shih raportet e statusit të zbatimit nga 29.09.2004.

III. ÇËSHTJET KYÇE

22. Raporti i Investigimit jep konstatimet e Panelit në një përmbledhje ekzekutive, në tekstin e hollësishëm dhe në një matricë, ku kjo e fundit është organizuar rreth nëntëmbëdhjetë çështjeve kryesore, sipas katër temave. Konstatimet, komentet dhe veprimet e Ekipit Drejtues janë organizuar sipas të njëjtave çështjeve, në Aneksin 1 të këtij raporti. Në rubrikën në vijim (Çështjet kryesore) jepet informacion shpjegues shtesë dhe konteksti për secilën prej katër temave, në përputhje me Aneksin 1.

Zbatimi i kërkesave mjedisore

23. ***Rreziqet e parashikuara për shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga TEC-in.*** Ekipi Drejtues me kënaqësi vëren konvergimin nga Paneli i Inspektimit lidhur me zbatimin e parashikuar të kërkesave ligjore nga shfrytëzimi i TEC-it lidhur me kufijtë e çlirimeve atmosferike dhe të shkarkimit të ujit ftohës. Ekipi Drejtues dëshiron të vërejë konstatimet e Panelit (në faqet xvi-xvii) se “*çlirimet atmosferike të TEC-it të Vlorës nuk përbëjnë ndonjë rrezik të ndjeshëm dëmtimi as për popullatën njerëzore të Vlorës e as për florën dhe faunën e Lagunës së Nartës.*” Gjithashtu, “*Ngritja e temperaturës së ujit në një vend, nga shkarkimi i ujit ftohës të TEC-it ... është shumë më poshtë se standardi maksimal i lejuar...*” Çlirimet atmosferike të parashikuara dhe të rishikuara priten të jenë brenda standardeve të BE-së për tre parametra kryesorë të cilësisë së ajrit (dioksidi i azotit, dioksidi i squfurit dhe grimcat) sikurse vërehet në Kutinë 2. Siç do të trajtohet edhe më poshtë, Ekipi Drejtues pajtohet me shqetësimin për rrjedhjet e naftës në det, mirëpo beson se në këtë drejtim është bërë shumë përpara. Një element kyç i Planit të Veprimit është garantimi i mëtejshëm i kësaj ecjeje përpara. Ekipi Drejtues pajtohet gjithashtu se monitorimi i vazhdueshëm i ajrit dhe ujit është shumë i rëndësishëm për t’u kujdesur që centrali të plotësojë standardet e projektit. Në procedurat operative të centralit përfshihet edhe monitorimi i vazhdueshëm i çlirimeve nga oxhaqet. Rezultatet duhet t’u dorëzohen autoriteteve mjedisore, ndërkohë që po bëhen plane për ta ndarë informacionin me shoqërinë civile.

Kutia 2: Modelim i përditësuar i çlirimeve atmosferike

Konsulenti Mjedisor i KESH-it, duke përdorur të dhëna meteorologjike dhe të monitorimit të ajrit, të mbledhura nga KESH-i në zonën e Vlorës, pranë vendndodhjes së Projektit, llogariti vlerat e pritura të çlirimeve atmosferike nga shfrytëzimi i termocentralit. Rezultatet dhe krahasimi i tyre me standardet e BE-së jepen në Aneksin 2 (Modelimi i çlirimeve atmosferike).

Në formë të përmbledhur, nuk ka asnjë rast në të cilin çlirimet të jenë më të mëdha se 17 për qind e standardeve të lejueshme të BE-së, ndërsa në shumë raste çlirimet priten të jenë më pak se 10 për qind e këtyre standardeve. Edhe kur skenarit më të keq të modelit i shtohet cilësia e ajrit, e regjistruar nga KESH-i në afërsi të centralit të Vlorës, përsëri nuk u afrohet kufijve të lejueshëm të udhëzimeve të BE-së për cilësinë e ajrit.

Modelimi i rastit me tri njësi CCGT (me kapacitet përafërsisht 300 MW) përsëri tregon se centrali do të shfrytëzohej brenda kërkesave ligjore të Direktivës së BE-së për Cilësinë e Ajrit, edhe kur parashikimeve të modelit u shtohen përqendrimit maksimale më të këqija të regjistruara nga KESH-i.

Pra, u arrit në përfundimin se, as shfrytëzimi i një CCGT-je të vetëm, as i një centrali me tri njësi, nuk do të përbënte, në vetvete, një shkëlqje të udhëzuesve përkatës të BE-së, madje edhe në ato pika ku vlerat janë më të larta (përgjithësisht, male të pabanuara në veriperëndim të vendndodhjes).

Burimi: Përditësim i Raportit Mjedisor të KESH-it, tetor 2008 dhe gusht 2009

24. **Vlerësimi Mjedisor dhe Shqyrtimi i Alternativave të Vendndodhjes.** Ekipi Drejtues e pranon konstatimin e Panelit të Inspektimit se Qeveria e Shqipërisë e përzgjedhi vendndodhjen për TEC-in (dhe investimet e lidhura me të) në vitin 2002, përpara se të niste Vlerësimi Mjedisor i hollësishëm për Projektin në 2003. Edhe pse Raporti i Investigimit konstaton mangësi në këtë qasje, lidhur me zbatimin e PO 4.01, Ekipi Drejtues mendon se angazhimi i Bankës gjatë kësaj faze, përpara Shqyrtimit të Konceptit, ishte konform praktikës së pranueshme dhe politikës së Bankës. Duke qenë se Banka kishte disa vjet që ishte partnere me Qeverinë e Shqipërisë për çështjet energjetike, gjatë vitit 2002 Banka i ka dhënë këshilla Qeverisë së Shqipërisë (dhe konsulentëve të saj) në mënyrë joformale, si një financuese e mundshme e TEC-it. Banka ishte në dijeni të parapëlqimit nga ana e Qeverisë së Shqipërisë për një TEC në Vlorë, si edhe të punës së konsulentëve të huaj të cilët po përgatishnin studimin e realizueshmërisë dhe studimin për vendndodhjen. Në kuadër të korrektësisë, Banka e nxiti Qeverinë e Shqipërisë të merrte në shqyrtim edhe vendndodhje të tjera alternative për TEC-in, krahas Vlorës. Ky rekomandim u pranua, sikurse pasqyrohet edhe në termat e referencës për konsulentin në prill 2002, dhe u ndoq edhe më pas në studimin për vendndodhjen, i cili u finalizua më 21 tetor 2002.

25. Gjatë Misionit Identifikues të Projektit në gusht 2002, stafi i Bankës dha komentet e veta për projekt-studimet paraprake për vendndodhjen dhe realizueshmërinë, lidhur me aspektet teknike, mjedisore, ekonomike dhe financiare. Ekipi shkoi në vendndodhjen në Vlorë dhe vërejti çështjet mjedisore që do të duhet të trajtoheshin në VNM-në e Projektit, përfshirë edhe efektet e mundshme në Lagunën e Nartës dhe krijimin e të dhënave të situatës bazë për cilësinë e ajrit dhe të ujit. Gjatë misionit, u informua Qeveria se procesi i VNM-së së Projektit do të niste me t'u përzgjedhur vendndodhja dhe u theksua periudha

me dy faza e konsultimeve për VNM-në. Komunikimet e mëparshme me BERZH-in kishin nënvizuar mundësinë e klasifikimit të Projektit të TEC-it si projekt i Kategorisë A, i cili u konfirmua brendapërbrenda Bankës në tetor 2002.

26. Banka filloi ta përgatisë zyrtarisht Projektin me nxjerrjen e Dokumentit të Informacionit të Projektit (DIP) më 2 janar 2003 dhe mbledhjen e brendshme për shqyrtimin e konceptit më 10 janar 2003. Fleta e parë me të dhënat për masat mbrojtëse të integruara të Projektit u hodh në InfoShop më 20 shkurt 2003, ku konfirmohej klasifikimi i VM-së i Kategorisë A.

27. Mbledhja për shqyrtimin e konceptit erdhi pas miratimit të truallit në Vlora B nga Këshilli i Rregullimit të Territorit i Vlorës më 21 dhjetor 2002 dhe menjëherë përpara miratimit nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit i Shqipërisë më 10 shkurt 2003, i vendndodhjes me vlerësimin më lartë (Vlora B) që kishte dalë nga faza e realizueshmërisë/studimit për vendndodhjen. Ndërkohë që veprimet e Qeverisë së Shqipërisë gjatë procesit të përzgjedhjes së vendndodhjes, në vetvete, nuk ishin objekti i PO 4.01, Banka mendonte se qasja me shumë kritere, të cilën kishin ndjekur konsulentët e huaj për shtatë vendndodhjet alternative⁶, ishte një praktikë e mirë. Banka e shqyrtoi me imtësi raportin e konsulentëve lidhur me këto vendndodhje dhe e konsideroi rekomandimin për Vlora B si rekomandim të shëndoshë nga ana teknike. Banka ishte në dijeni të mbledhjes publike (të zhvilluar më 31 tetor 2002) që u organizua pas daljes së studimit përfundimtar për vendndodhjen, mirëpo, sikurse vëren edhe më pas në këtë raport, Banka e pranon se do të kishte qenë i dëshirueshëm një konsultim më i hershëm me komunitetet që mund të prekeshin.

28. Procesi i korrektësisë i Bankës konfirmoi se vendndodhja Vlora B meritonte vlerësimin më të lartë dhe se mund të fillonte një VNM për Projektin, për të hetuar përshtatshmërinë e plotë të saj. Ekipi Drejtues e thekson se VNM-ja nuk ishte thjesht për të mbështetur përzgjedhjen e vendndodhjes Vlora B, por për të vlerësuar rreziqet, për të përcaktuar masat e zbutjes së rrezikut dhe për t'u kujdesur që të plotësoheshin kërkesat e politikave të Bankës. Më pas, rezultatet e studimit për vendndodhjen (përfshirë edhe depistimin mjedisor) u përfshinë në rubrikën e kërkuar për alternativat në VNM, sikurse e kërkon PO 4.01 për një projekt të Kategorisë A. Ekipi Drejtues beson se dhënia e informacionit dhe konsultimit për VNM-në e Projektit, që erdhi më pas, solli përmirësime të ndjeshme në procedurat e mëparshme të Shqipërisë.

29. ***Instrumentet e Vlerësimit Mjedisor dhe Zbatimi i tyre për Projektin.*** Sa më sipër, Ekipi Drejtues e pranon se VNM-ja e Projektit u përqendrua te rreziqet dhe masat zbutëse për një TEC në vendndodhjen e vlerësuar më lart, pranë Vlorës. Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë qëndrimin e tij lidhur me instrumentet e tjera të vlerësimit mjedisor të cilat, sipas mendimit të Panelit, mund të jenë të nevojshme për të zbatuar PO 4.01, në bazë të pohimit në Raportin e Investigimit lidhur me *“mosbërjen e një analize të efektit progresiv të termocentralit së bashku me pajisjet ndihmëse të tij (siç është terminali i*

⁶ Shtatë vendndodhjet qenë Durrësi, Elbasani, Fieri, Korça, Shëngjini, Vlora A (ish-fabrika e sodës kaustike, e cila ndodhej në gjendje të kontaminuar) dhe Vlora B (truall i pandërtuar, ai që u zgjodh përfundimisht).

naftës në mes të ujërave të Gjirit) dhe së bashku me investimet shoqëruese që janë menduar tashmë nga Qeveria huamarrëse apo investitorë të tjerë në zonën rreth TEC-it.”⁷

30. **VNM e Projektit.** Ekipi Drejtues vëren se VNM-ja e Projektit përfshin raportin përfundimtar të vlerësimit mjedisor dhe Shtojcën e VNM-së (përfshirë edhe një PAM) për TEC-in 100 MW⁸ dhe investimet shoqëruese (marrësi dhe shkarkuesi i ujit ftohës; linja e furnizimit të naftës; dhe linja e transmetimit të energjisë) të financuara nga Projekti.⁹ TEC-i mbetet i vetmi investim infrastrukture që ishte objekt i vlerësimit të Bankës dhe që mbulohej nga kredia e SHNZH-së. Mbledhja për Vendimin e miratoi VNM-në e Projektit si një dokument që i plotësonte kërkesat e PO 4.01 për projektet e Kategorisë A, të cilat Qeveria e Shqipërisë ishte dakord t’i zbatonte. Sikurse diskutohet më poshtë, në vënien në zbatim të Projektit u morën parasysh rreziqet nga investimet shoqëruese kyçe, në veçanti nga naftës-jellësi. Secili prej tre dokumenteve të njëpasnjëshme të VNM-së së Projektit (projekt-vlerësimi, vlerësimi përfundimtar dhe shtojca) pasqyronin konsultimet brenda dhe jashtë Bankës, në mënyrë të përsëritur, për të fuqizuar analizën e faktit nëse ishte apo jo e përshtatshme vendndodhja në Vlorë për të plotësuar kërkesat e Bankës, të IFN-ve të tjera dhe të Shqipërisë. Kjo metodë me përsëritje u përdor edhe për PAM-në, i cili ishte pjesë e VNM-së së Projektit dhe, më pas, u përforcua edhe në kontratën e PPN-së dhe projektimin e objektit.

31. **Efektet Progressive.** Ekipi Drejtues e pranon se VNM-ja e Projektit duhet të kishte qenë më e qartë lidhur me mbulimin e efekteve të mundshme progresive të dy njësive prodhuese, krahas asaj që bashkëfinancohet nga Banka (të cilat do ta zgjeronin TEC-in e Vlorës deri në kapacitetin 300 MW, që mund të mbajë objekti). Ekipi Drejtues sqaron se, ndërkohë që studimet e realizueshmërisë dhe të vendndodhjes të realizuar nga Qeveria e Shqipërisë e shqyrtonin si mundësinë me kapacitet 100 MW, ashtu edhe atë me kapacitet 300 MW, Banka dhe bashkëfinancuesit e saj mendonin se mundësia financiare e njësive shtesë në periudhën afatshkurtër deri afatmesme ishte shumë e ulët. Ekipi Drejtues vëren se ky qëndrim vlen ende edhe sot, pas tetë vjetësh.

32. Përkundër fokusit të deklaruar vetëm të një njësi, gjatë VNM-së u bënë llogaritjet fillestare të çlirimeve në ajër dhe ujë nga një objekt me kapacitet 300 MW. Megjithatë, Ekipi Drejtues e pranon se paraqitja e të dhënave mbi efektin progresiv në ajër dhe ujë nuk ishin nënvizuar qartë në VNM-në përfundimtare të Projektit, çka ka shkaktuar konfuzion.¹⁰ Ekipi Drejtues vëren se konsulentët mjedisorë të KESH-it kanë dhënë llogaritje të përditësuara të çlirimeve atmosferike nga një objekt me kapacitet 300 MW, mbështetur në matjet e cilësisë së ajrit, që janë bërë përpara fillimit të punimeve

⁷ Raporti i Investigimit, faqe xxxv, në fund.

⁸ VM e Projektit përmend një central me kapacitet midis 90 dhe 130 MW, çka ishte e përshtatshme po të kihet parasysh qasja me PPN, mirëpo për hir të prezantimit në këtë raport përdoret emërtimi 100 MW.

⁹ Gjendet në hapësirën në internet të Bankës Botërore, me adresë (<http://web.worldbank.org/external/projects/main?pagePK=51351038&piPK=51351152&theSitePK=40941&projid=P077526>).

¹⁰ Llogaritjet e “shumëzuara” për një njësi me kapacitet 300 MW që ishin përfshirë në projekt-dokument ishin përfshirë edhe në dokumentin përfundimtar, mirëpo nuk ishin emërtuara si të tilla, sepse thuhej se llogaritjet ishin vetëm për një njësi me kapacitet 100 MW.

ndërtimore. Këto llogaritje bëjnë të ditur se, për një objekt me kapacitet 300 MW, të gjithë parametrat kyç (grimcat në ajër, dioksidi i azotit dhe dioksidi i squfurit) do të ishin brenda kufijve të lejueshëm krahasuar me udhëzuesit e zbatueshëm të BE-së apo Bankës Botërore (shih Kutinë 2, më lart). Efektet termike në Gjirin e Vlorës nga shkarkimi i ujit ftohës prej një objekti me kapacitet 300 MW parashikohen të jenë brenda kufijve të lejueshëm, sikurse vëren edhe Paneli.

33. **Konsideratat e VM-së së Sektorit Energjetik.** Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë pikëpamjet e tij lidhur me konstatimin e Panelit se në VNM nuk trajtoheshin “investimet e mëpasshme të cilat janë menduar qysh më parë nga Qeveria huamarrëse apo investitorë të tjerë në zonën rreth TEC-it.”¹¹ Raporti i Investigimit sugjeron se duhet të ishte përgatitur një VM sektoriale, e cila të mbulonte, për shembull, naftësjiellësin e propozuar ARMO¹² dhe terminalin e depozitave të naftës në bregdet (i cili ishte ngritur në vitin 2002) dhe përmend kompleksin e centralit energjetik me erë në Gadishullin e Karaburunit dhe linjën elektrike nëndetare të propozuar për t’u lidhur me Italinë. Ekipi Drejtues është e mendimit se, duke qenë se nuk kishte asnjë lidhje financiare apo ekonomike të vlerësueshme midis këtyre investimeve dhe TEC-it, atëherë nuk ishte e nevojshme të kryhej një VM për sektorin e energjisë. TEC-i ishte i justifikuar, më vete, për të mbushur pjesërisht boshllëkun në kërkesën kombëtare për energji. Ekipi Drejtues vëren se koncepti i naftësjiellësit nuk ka ecur përpara, depozitat e naftës (të ndërtuara dhe shfrytëzuara nga një konsorcium privat i quajtur La Petrolifera) nuk u pranuan si burim i vetëm nga Qeveria për të furnizuar TEC-in dhe, në përgjithësi, plotëson nevoja të tjera nga ato të TEC-it, ndërsa kompleksi i prodhimit të energjisë me erë dhe kabloja nëndetare në Gadishullin e Karaburunit kanë lindur si ide vetëm në vitin 2008. Ekipi Drejtues i qëndron mendimin se nuk ka asnjë kërkesë të politikave të cilat t’u kërkojnë huamarrësve të realizojnë një VM sektoriale për një varg investimesh pa një lidhje financiare apo ekonomike të qartë me investimet konkrete të infrastrukturës që janë objekti i shqyrtimit për financim nga Banka.

34. **Konsideratat Strategjike ose Rajonale të VM-së.** Ekipi Drejtues vëren shqetësimin e Panelit se çështjet më strategjike apo të zhvillimit rajonal nuk janë trajtuar në VNM-në e Projektit dhe dëshiron të sqarojë qëndrimin e tij lidhur me këtë. Krahas investimeve të mundshme në sektorin energjetik, të përmendura më lart, në zonën e Vlorës janë propozuar edhe investime të tjera gjatë periudhës së përgatitjes dhe, më pas, të vënies në zbatim të Projektit. Këtu përfshihet “parku industrial/energjetik” përreth TEC-it, si edhe disa zgjedhje madhore të zhvillimit strategjik të propozuara për Vlorën, si për shembull zgjerimi i peshkimit (përfshirë edhe akuakulturën), zgjerimi i turizmit (përfshirë edhe kompensimet me zhvillimin energjetik/industrial), zgjerimi i mundshëm i Vlorës si një port i thellë me terminal për kontejnerë, një park i dytë industrial dhe një kompleks i madh banimi në bregdetin perëndimor të Lagunës së Nartë.

35. Ekipi Drejtues i qëndron mendimit se, edhe pse vendndodhja e TEC-it gjendet në anë të një “parku industrial/energjetik” të miratuar, investimet e tjera brenda parkut nuk ishte ende të përcaktuar mirë gjatë përgatitjes së Projektit dhe, me përjashtim të terminalit

¹¹ Raporti i Investigimit, faqe xxxv.

¹² Shoqëria Shqiptaro-Maqedonase-Bullgare e Naftës

të naftës, të përmendur më lart, i cili nuk kishte lidhje me Projektin, asnjëri prej tyre nuk është zhvilluar deri tani. Sikurse vërehet më lart, TEC-i me kapacitet 100 MW, i financuar nga Banka, do të plotësojë një boshllëk në nevojat për energji dhe nuk ishte menduar të plotësonte në mënyrë specifike nevojat e një parku. Çka është më e rëndësishme, sikurse thuhet më lart lidhur me VM-në sektoriale, Ekipi Drejtues është i mendimit se nuk kishte asnjë lidhje financiare apo ekonomike të vlerësueshme midis këtyre investimeve dhe TEC-it. Për rrjedhojë, nuk ishte e nevojshme të bëhej një VM strategjike apo rajonale për të zbatuar PO 4.01. Disa prej ideve për investime të mundshme që janë sugjeruar qysh prej përgatitjes së Projektit kanë marrë miratimin e parë nga qeveria, mirëpo shumë të tjera mbeten jo të konfirmuara. Qeveria e Shqipërisë nuk kishte kërkuar kredi nga Banka apo asistencë këshillimore për çështjet e investimeve strategjike në Vlorë përpara apo gjatë përgatitjes së Projektit, ndërsa Ekipi Drejtues nuk e konsideroi të nevojshëm një angazhim të tillë për të plotësuar kërkesat e politikave për TEC-in. Ekipi Drejtues mendon edhe se përparimet në Rregullimin e Territorit të Shqipërisë (sikurse diskutohet në këtë raport, më poshtë) janë një mjet i përshtatshëm për të trajtuar shqetësimet e gjera zhvillimore.

36. **Pavarësia e Konsulentëve të VNM-së së Projektit.** Ekipi Drejtues vëren konstatimin e Panelit të Inspektimit lidhur me moszbatimin e PO 4.01 për përdorimin e të njëjtës firmë konsulente për studimin e realizueshmërisë dhe për VNM-në. Ekipi Drejtues pajtohet me Panelin se është e dëshirueshme të ketë një veçim të VM-së nga projektimi, në mënyrë që të evitohet konflikti i mundshëm i interesit dhe, në të vërtetë, kjo është kthyer në normë për shumicën e projekteve të Kategorisë A. Në rastin e këtij Projekti ishte e nevojshme një qasje alternative, duke qenë se e gjithë asistenca përgatitore për Qeverinë e Shqipërisë po jepej në kuadër të një kontrate të financuar nga USTDA-ja dhe, në bazë të një qasjeje me kontratë PPN, realizimi i projektit teknik bëhet gjatë vënies në zbatim.

37. Për asistencë në financimin e një shqyrtimi të pavarur të një raportit të VNM-së, Banka iu drejtua Qeverisë së Kanadasë, e cila, përmes agjencisë së saj për zhvillim ndërkombëtar, CIDA, kishte mbështetur punën sektoriale për furnizimin me energji në Evropën Juglindore. CIDA përzgjedhi një konsulent për të shqyrtuar projekt-raportin e VNM-së, i cili dha më pas komente në tetor 2003, në dymbëdhjetë fushat tematike, në funksion të fuqizimit të dokumenteve. Këto u morën parasysh nga Banka Botërore, BERZH-i dhe konsulenti i VNM-së dhe u pasqyruan si në VNM-në Përfundimtare në tetor 2003 ashtu edhe në një Shtojcë të muajit dhjetor 2003 (së bashku me VNM-në e Projektit) e cila përfshinte shqyrtime të tjera nga stafi i Bankës dhe i BERZH-it. Edhe pse Ekipi Drejtues pajtohet me komentën se ky proces i përsëritur nuk ishte optimal dhe vëren se do të përpiqet t'i minimizojë mënyra të tilla pune në të ardhmen, përdorimi i një firme të pavarur dhe i stafit nga të dy IFN-të u konsiderua i mjaftueshëm nga Ekipi Drejtues për të arritur qëllimet e PO 4.01 lidhur me evitimin e konfliktit të interesit. Ekipi Drejtues nuk ishte në dijeni të asnjë lidhjeje financiare apo teknike midis konsulentit të përzgjedhur nga CIDA dhe konsulentit që përgatiti VNM-në e financuar nga USTDA. Ekipi Drejtues e konsideronte përvojën e konsulentit të CIDA-s në fushën e sektorit energjetik të Evropës Juglindore si një avantazh të vlefshëm për realizimin e shqyrtimit të pavarur të VNM-së.

38. **Aspekte të tjera të Procesit të Vlerësimit Mjedisor.** Renditja kohore e hapave të VM-së, të realizuar gjatë përgatitjes zyrtare të Projektit nga Banka jepet e përmbledhur në paragrafët 39-43 të Përgjigjes së Ekipit Drejtues për Kërkesën për Inspektim nxjerrë në datën 1 janar 2007 dhe, kështu, nuk përsëritet këtu. Ekipi Drejtues i vëren me shqetësim deklaratat në Raportin e Investigimit, të cilat hedhin dyshime mbi cilësinë e VNM-së dhe mbi proceset shqyrtuese të Bankës dhe të IFN-ve partnere me të. Ekipi Drejtues beson se VNM-ja e Projektit kishte me siguri një cilësi, të paktën, të mjaftueshme dhe pasqyrore një oponencë teknike të shëndoshë profesionale dhe të imët të bërë nga stafi i Bankës dhe homologët e tyre në IFN-të bashkëfinancuese. Procesi i VM-së kishte përsëritje dhe, në rastin e Projektit, përfshinte një projekt-raport të VNM-së, konsultime publike për projekt-dokumentin, një raport përfundimtar të VNM-së dhe një Shtojcë, për të pasqyruar diskutimet e mëpasshme dhe oponencën teknike nga specialistët e Bankës dhe të BERZH-it.

39. Ekipi Drejtues vëren se qasja që ndoqi BERZH-i për VM-në ishte mjaft e krahasueshme me atë të Bankës Botërore. Në lidhje me këtë, Ekipi Drejtues vëren se Raporti i Shqyrtimit të Zbatimit i Mekanizmit të Shqyrtimit të Brendshëm i BERZH-it (i nxjerrë më 17 prill 2008, në përgjigje të një ankese për TEC-in, marrë më 19 prill 2007) nuk “konstatoi që BERZH-i të mos e kishte përmbushur detyrimin e saj për të siguruar realizimin e një VNM-je adekuate nga Mbështetësi i Projektit”, si edhe se “VNM Përfundimtare i muajit tetor 2003, së bashku me Shtojcën e VNM-së e muajit tetor 2003, i trajtonin çështjet dhe përmbanin më shumë se minimumi i informacionit që kërkon Politika Mjedisore e BERZH-it.”¹³

40. Megjithatë, Ekipi Drejtues vëren se, përkundër mjaftueshmërisë së përgjithshme të VNM-së të Projektit, Raporti i Investigimit nënvizon disa mangësi më të vogla në procesin e VM-së. Sqarimi i një sere prej tyre nga ana e Ekipit Drejtues jepet në Aneksin 1.

41. **Parandalimi dhe Kundërpërgjigja ndaj Rrjedhjeve të Naftës.** Ekipi Drejtues pajtohet me Panelin e Inspektimit lidhur me nevojën për t’u siguruar që TEC-i të ketë procedurat e duhura për parandalimin e “efektit mjedisor mundësisht të rëndë nga rrjedhjet e mundshme të naftës gjatë furnizimit me lëndë djegëse.” Lidhur me mendimin e Panelit se “... nuk janë minimizuar rreziqet afatmesme dhe afatgjata që i kanosen mjedisit detar dhe plazheve të Gjirit të Vlorës nga rrjedhjet e mundshme gjatë shkarkimit të lëndës djegëse dhe se nuk ka plane për minimizimin e këtyre rreziqeve përpara fillimit të shfrytëzimit...”¹⁴ Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë se rreziqet e rrjedhjeve të naftës ishin të identifikuar mirë gjatë përgatitjes së Projektit. Janë përmendur shprehimisht rreziqet e rrjedhjeve të naftës, si gjatë ndërtimit ashtu edhe gjatë shfrytëzimit, në VNM-në e Projektit, ndërsa në PAM u futën masa për administrimin dhe zbutjen e këtyre rreziqeve. Nga ana e tij, PAM ishte pjesë e dokumenteve të tenderit për kontratën e PPN-së (Aneksi 5) për të ndërtuar TEC-in e Vlorës. Kjo është një praktikë e zakonshme, për të siguruar që pala e kontraktuar të realizojë punimet dhe projektet teknike në përputhje me

¹³ Citime nga paragrafët 42 dhe 43; “Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim; Mekanizmi i Pavarur Ligjor: Raporti i Shqyrtimit të Zbatimit lidhur me projektin e termocentralit të Vlorës.” 17 prill 2008. Gjendet në <http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/0701crr.pdf>.

¹⁴ Shih faqet xvii-xviii të Raportit të Investigimit.

PAM-në.¹⁵ PAM kërkon shprehimisht që pala e kontraktuar për PPN-në të përgatisë: (i) një Plan për Parandalimin e Rrjedhjeve të Naftës (për të minimizuar rreziqet e rrjedhjes së naftës); dhe (ii) një Plan Kundërpërgjigje ndaj Rrjedhjeve të Naftës (për të pastruar derdhjet e naftës nëse do të ndodhin, përkundër masave parandaluese). Krahas këtyre, dokumentet juridike të Projektit përfshijnë një dispozitë specifike, e cila i kërkon KESH-it të kujdeset për vënien në zbatim të PPN-së,¹⁶ me fjalinë: “*KESH-i merr ose kujdeset që të merren të gjitha masat e nevojshme për realizimin në kohë të PAM-së...*”

42. Deri më 3 shtator 2009, Planet e Parandalimit dhe Kundërpërgjigjes ndaj Rrjedhjeve të Naftës për objektet bregdetare të TEC-it të Vlorës, përfshirë edhe pajisjet dhe strukturat e kufizimit të dëmit, vazhdonin të ishin në zbatim. Lidhur me objektet në det, ekziston Plani i Parandalimit të Rrjedhjeve të Naftës, ndërkohë që është duke u finalizuar Plani i Kundërpërgjigjes ndaj Rrjedhjeve të Naftës dhe sipas Kontratës së Kredisë me Bankën, duhet të jetë në zbatim përpara se të fillojë shfrytëzimi i TEC-it.

43. Qeveria e Shqipërisë dhe Banka e kanë pranuar se KESH-i nuk i ka njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kontrollin mbikëqyrës të aspekteve mjedisore të ndryshme të Projektit të TEC-it të Vlorës. Për këtë qëllim, është financuar, në kuadër të komponentit të asistencës teknike të Projektit të Prodhimit dhe Ristrukturimit të Sektorit të Energjisë, edhe një konsulencë tjetër më vete, e cila përqendrohet vetëm te çështjet mjedisore. Pranë KESH-it është krijuar një Njësi e Administrimit Mjedisor (NJAM), për të ndjekur aspektet mjedisore të Projektit, dhe, qysh prej vitit 2006, kësaj njësie i është dhënë konsulencë specifike. Është marrë me nënkontratë edhe një firmë konsulente e njohur në botë, me njohuri teknike specifike për rrjedhjet e naftës. Një detyrë kyçe e firmës ishte: “*Shqyrtimi i një plani për parandalimin dhe kundërpërgjigjen ndaj rrjedhjeve të naftës që përgatitet nga pala e kontraktuar për PPN-në.*”

44. Për shkak të vonesës në caktimin e kontratës së PPN-së, kontrata për Konsulencën Mjedisore mbeti pezull deri në prill 2007, kur KESH-i dhe Konsulenti e shpallën kontratën aktive. Pala e kontraktuar për PPN-në filloi punimet projektuese dhe ndërtimore në truallin e Projektit në maj 2007.

45. Në bazë të përparimit të punimeve, duke filluar në tetor 2008, ekipi i Projektit i Bankës, së bashku me bashkëfinancuesit, i kërkuan KESH-it të jepte planet e parandalimit dhe kundërpërgjigjes së rrjedhjeve të naftës. Kështu, KESH-i kërkoi palës së kontraktuar për PPN-në të fillonte përgatitjen e planeve të parandalimit dhe kundërpërgjigjes për rrjedhjet e naftës. Pala e kontraktuar për PPN-në e paraqiti planin e parandalimit të rrjedhjeve të naftës në maj 2009. Konsulenti Mjedisor e shqyrtoi këtë plan

¹⁵ Përgjegjësia parësore për përgatitjen e hollësishme dhe vënien në zbatim të PAM-së, me kontratë i bie palës së kontraktuar për PPN-në, sepse PAM është pjesë integrale e kontratës së PPN-së. Për shembull, në bazë të Rubrikës VI, 1.4.7, të Kontratës së PPN-së, pala e kontraktuar ka detyrimin “të përgatisë një plan për parandalimin e rrjedhjeve të naftës për një skenar të mundshëm të rrjedhjeve të kimikateve dhe/ose naftës gjatë periudhës së ndërtimit.” Po kështu, sipas Rubrikës së Specifikimeve Teknike të PPN-së, Aneksi V, Tabela 8.2, “Zbutja gjatë fazës së shfrytëzimit”, pala e kontraktuar për PPN-në ka detyrimin “të paraqesë një plan për parandalimin dhe kundërpërgjigjen ndaj rrjedhjeve të naftës, me pajisjet e nevojshme të kundërpërgjigjes, masat zbutëse dhe një program trajnimi për personelin në bazë.”

¹⁶ Kontrata e Projektit, e nënshkruar midis KESH-it dhe Bankës Botërore, më 6 prill 2004; shih, Lidhja 2, Programi i Zbatimit, rubrika 3.

dhe dha komentet e veta. Ekipi Drejtues beson se projektimi dhe ndërtimi i objekteve në det të lëndës djegëse janë të standardeve ndërkombëtare dhe se janë minimizuar rreziqet e rrjedhjes së naftës gjatë shkarkimit të lëndës djegëse. Në fund, Ekipi Drejtues vëren se pritet që TEC-i i Vlorës të marrë 15 deri 20 depozita të vogla (domethënë, mbase 10.000 ton) në vit (duke supozuar një shfrytëzim me ngarkesë bazë rreth 80 për qind).

46. **Veprimi i Bankës për të Ndrequr Mangësitë.** Duke qenë se nuk është ende tërësisht i gatshëm Plani i Kundërpërgjigjes ndaj Rrjedhjeve të Naftës në det, Banka do të mbikëqyrë përfundimin e këtij plani përpara futjes në shfrytëzim rutinë të objektit (çka mendohet, hë për hë, se do të ndodhë në fillim të muajit nëntor 2009), siç e kërkon edhe Kontrata e Kredisë.

Vlerësimi Ekonomik i Alternativave

47. Kjo rubrikë e raportit ka të bëjë me konstatimet e Panelit përgjithësisht në kuadër të zbatimit të PO 10.04 “Për vlerësimin ekonomik të operacioneve të investimeve” dhe DMP 2.20 “Për vlerësimin e projekteve”.

48. Ekipi Drejtues vëren konstatimin e Panelit për analizën ekonomike të Projektit, i cili konfirmon kthimin ekonomik pozitiv të lartë të këtij Projekti për ekonominë shqiptare. Këtu vërehet edhe deklarimi nga ana e Panelit se “(a) futja e një teknologjie dhe strukture kostoje si ajo e TEC-it në strukturën e tanishme të kostove dhe ofertës në tregun shqiptar ka pafundshmërisht kuptim...”¹⁷

49. **Rivlerësimi i Shkallës Ekonomike të Vendndodhjes së Fierit.** Ekipi Drejtues vëren se raporti i Panelit lidhur me analizën ekonomike që çoi në përzgjedhjen e vendndodhjes Vlora B bën një analizë ex-post të alternativës së ndërtimit të të njëjtit TEC në Fier (vendndodhja e cila doli e dyta në renditjen e bërë në studimin për vendndodhjen nga konsulenti), mirëpo nuk arrin në ndonjë përfundim nëse duhej të ishte zgjedhur kjo vendndodhje në bazë të analizës ekonomike të kostove dhe përfitimeve. Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë disa çështje të caktuara lidhur me analizën e Panelit për Fierin, e cila ka prirjen të bëjë të ditur se edhe sot, kur kemi mundësinë t’i hedhim sytë mbrapa dhe kur kemi fituar njohuri të tjera shtesë krahasuar me kohën kur është vlerësuar Projekti, mbi bazën analizës ekonomike vendndodhja në Vlorë përsëri mund të dilte si më e preferuara. Paneli bën disa rregullime të caktuara për të rivlerësuar llogaritjet e kostove të niveluara, të paraqitura në studimin për vendndodhjen, duke krahasuar vendndodhjet Fier dhe Vlora B. Në lidhje me këtë, Ekipi Drejtues dëshiron të theksojë si më poshtë. Së pari, objekti për shkarkimin e lëndës djegëse, i ndërtuar për Vlora B, do të kishte qenë i nevojshëm edhe për centralin në Fier. Fieri nuk ndodhet në bregdet, kështu që do të ekzistonte nevoja për të transportuar sasinë e mjaftueshme të lëndës djegëse deri në central, çka do të kërkonte një naftësjellës të gjatë, i cili do të shoqërohej nga potenciali për efekte mjedisore gjatë ndërtimit. Duke pasur parasysh afërsinë e Fierit me Gjirin e Vlorës dhe mungesën e porteve të afërt alternativë, ka shumë të ngjarë që edhe për Fierin të ishin të nevojshme objekte të lëndës djegëse të ngjashme me ato ekzistueset. Rrjedhimisht, rregullimi i kostos kapitale për Vlora B vlen edhe për alternativën në Fier. Së dyti, kur, në

¹⁷ Raporti i Investigimit, Aneksi D, faqe 115.

vitin 2007, KESH-i iu drejtua palës së kontraktuar për PPN-në për të negociuar një zbritje në çmim për largimin e mundshëm të objekteve të lëndës djegëse në det në kuadër të Projektit (duke menduar alternativën e Petroliferës), pala e kontraktuar për PPN-në bëri të ditur se vlera gjithsej e kontratës do të zvogëlohej vetëm me 3 milion dollarë amerikanë (dhe jo 6 milion dollarë amerikanë, sikurse thuhet në faqen 66 të raportit të Panelit). Sa më lart, rregullimet e bëra në raportin e Panelit çojnë në një mbivlerësim të kostove të Vlora B. Megjithatë, edhe pas këtyre rregullimeve, duket qartë se vendndodhja Vlora B është zgjedhja më e mirë në bazë të kostove të “internalizuara”.

50. Lidhur me kostot eksternale, Paneli vëren eksternalitetet e: (i) dëmit ndaj peshkimit; dhe (ii) turizmit.

51. **Peshkimi.** Ekipi Drejtues pajtohet me konstatimet e Panelit: “(i) *çlirimet atmosferike nuk përbëjnë ndonjë rrezik të ndjeshëm dëmtimi as për popullatën njerëzore të Vlorës e as për florën dhe faunën e Lagunës së Nartës;*”¹⁸ dhe (ii) mjedisi detar nuk do të preket ndjeshëm nga vënia në punë e sistemit ftohës së centralit.¹⁹ Pra, duket se i vetmi dëm i mundshëm ndaj peshkimit mund të ishte një rrjedhje e mundshme e një shkalle aq të madhe sa ta dëmtonte në mënyrë të pariparueshme peshkimin në Gjirin e Vlorës. Analistët e Panelit vlerësojnë se dëmi ndaj peshkimit mund të jetë me një vlerë vjetore prej 843.000 dollarë amerikanë.²⁰ Ekipi Drejtues dëshiron të theksojë se kjo vlerë dëmi do të kërkonte ndodhjen e rastit më të keq (për shembull, përplasjen e dy depozitave me njëra tjetrën), dhe jo me ndonjë gjë të lidhur me shkarkimin e zakonshëm të lëndës djegëse për TEC-in në vend-ankorim. Gjithashtu, që të lindin kosto të tilla vjetore, do të duhej të supozohej rasti më i keq (domethënë, po të mos pastrohej për shumë vjet nafta e derdhur).

52. Lidhur me krahasimin e dy vendndodhjeve Vlora B dhe Fier, nëse duam t’i marrim në konsideratë eksternalitete të tilla, Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë se rreziqet e rrjedhjes së naftës vlejné njësoj si për vendndodhjen në Fier ashtu edhe për vendndodhjen Vlora B, duke qenë se të dy vendndodhjet do të përdornin objekte të ngjashme për lëndën djegëse. Pra, nuk do të kishte ndryshuar vlerësimi i përzgjedhjes së vendndodhjes.

53. Megjithatë, Ekipi Drejtues vëren se rreziku që i vjen peshkimit nga një rrjedhje naftë është identifikuar gjatë VNM-së dhe është trajtuar përmes PAM-së. PAM kërkon shprehimisht që pala e kontraktuar për PPN-në të përgatisë: (i) një Plan për Parandalimin e Rrjedhjeve të Naftës; dhe (ii) një Plan Kundërpërgjigje ndaj Rrjedhjeve të Naftës. Projekti ka financuar edhe një kontratë më vete për Konsulencë Mjedisore për KESH-in, në mënyrë që të asistohet ky i fundit për të siguruar një zbatim si duhet të PAM-së. Sikurse është thënë më parë, njëra prej katër detyrave specifike të Konsulencës Mjedisore ka të bëjë me vënien në zbatim të PAM-së, sidomos lidhur me Parandalimin dhe Kundërpërgjigjen për Rrjedhjen e Naftës. Staf i Bankës dhe KESH-i janë takuar disa herë me peshkatarët që bazën e kanë në portin ngjitur me TEC-in për t’i informuar ata

¹⁸ Raport i investigimit, para. 169, faqe 40.

¹⁹ Raport i investigimit, para. 174, 175.

²⁰ Raport i investigimit, para. 296.

lidhur me përparimin në fushën e zvogëlimit të këtyre rreziqeve dhe ata i kanë pritur mirë dhe i kanë mbështetur këto masa.

54. Duke pasur parasysh strukturimin e Projektit: (i) për të minimizuar rreziqet e rrjedhjes së naftës (Plan për Parandalimin e Rrjedhjeve të Naftës); dhe (ii) për të zbutur çdo rrezik tjetër të mbetur (Plan Kundërpërgjigje ndaj Rrjedhjeve të Naftës), Ekipi Drejtues beson se analiza ekonomike e Projektit, në mënyrë të saktë, u jep pak vlerë kostove të eksternalitetit lidhur me dëmin ndaj peshkimit.

55. **Turizmi.** Ekipi Drejtues pajtohet me konstatimet e Panelit:²¹ *“Vetë trualli i TEC-it nuk është një zonë natyrore e virgjër me ndonjë potencial të madh për të tërhequr turistë. [Ishulli i Zvërnecit dhe Kepi i Treportit, si edhe pjesa më e madhe e vijës bregdetare të Gjirit të Vlorës] asnjëra prej këtyre nuk do të preken nga TEC-i ...”* Megjithatë, Paneli konstaton se mund të mbetet në rrezik “ndjesia e vendit” e Kepit të Treportit dhe Gjirit të Vlorës si pikë turistike e dëshirueshme, për shkak të shfrytëzimit të TEC-it dhe zhvillimeve të tjera të propozuara.²²

56. Ekipi Drejtues e pranon se mund të ketë disa efekte, të lokalizuara dhe të ngushta në zonën e Projektit, lidhur me turizmin. Ngaqë termocentralet kanë nevojë të jenë pranë rrugëve ujore për transportimin e sasive të mëdha të lëndës djegëse dhe për të përdorur sasi të konsiderueshme uji për ftohje, nuk ndodh rrallë që centrale të tilla të ndërtohen pranë detit. Një numër i konsiderueshëm ishujsh në Mesdhe kanë ndërtuar termocentrale në brigjet e tyre, dhe, përsëri, turizmi ka ecur përpara me vrull si pasojë, ndër të tjera, edhe e një furnizimi të sigurt me energji elektrike.

57. Ekipi Drejtues e pranon se disa kosto eksternale të lidhura me turizmin nuk janë marrë në konsideratë në analizën ekonomike të Projektit. Megjithatë, kosto të tilla nuk do ta kishin ndryshuar ndjeshëm vlerësimin ekonomik të Projektit, sepse ka shumë të ngjarë që ato të kompensoheshin nga përfitimet që do t'i vinin turizmit nga furnizimi i sigurt me energji. Krahas kësaj, Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë se, shprehur në terma vjetorë, do të duhej që këto kosto ta kalonin vlerën 1,8 milion dollarë amerikanë për vendndodhjen në Fier, në mënyrë që të zgjidhej ajo dhe jo Vlora B. Duke pasur parasysh faktin se trualli i TEC-it është i vogël dhe se nuk ka efekte të drejtpërdrejta në Gjirin e Vlorës, sikurse e pranon edhe Paneli, nuk ka të ngjarë që humbjet e mundshme në të ardhurat nga turizmi të ishin aq të larta saqë të justifikonin kostot shtesë të ndërtimit të centralit në Fier.

58. Ekipi Drejtues pranon edhe se, nëse bëhen ndërtime të tjera industriale në zonë, mund të preket turizmi në zonën e Treportit. Por, kjo është një çështje e cila trajtohet përmes ligjit të ri shqiptar për rregullimin e territorit.²³

²¹ Raport i investigimit, para. 107.

²² Po aty.

²³ Citohet zyrtarisht si Ligji Nr 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”. Teknikisht, ky ligj ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr 56 (botuar më 8 maj 2009) edhe pse zbatimi i plotë do të fillojë më shtator 2010, kur të shfuqizohet plotësisht Ligji Nr 8405, datë 16.09.1998, “Për urbanistikën”.

Zbatimi i Politikave Sociale dhe Kulturore

59. Paneli konstatoi se “Banka nuk u përpoq të merrte informacion për praninë dhe rolin e pasurive kulturore në zonën e Vlorës.”²⁴ Ekipi Drejtues e pranon se gjatë përgatitjes së Projektit nuk u realizua një vërtetim në terren i burimeve kulturore dhe se gabimisht ka thënë se nuk kishte asnjë burim lidhur me trashëgiminë kulturore në këtë zonë. Praktika e Bankës ishte ta vinte në lëvizje NPO 11.03 vetëm kur kishte arsye për të dyshuar se Projekti mund të trazonte mbetje arkeologjike apo burime të tjera kulturore të rëndësishme. Sikurse vërehet nga Paneli, një mision mbikëqyrjeje në vitin 2006, në të cilin bënte pjesë një arkeolog profesionist, konstatoi se nuk kishte të ngjarë që atje të gjendej ndonjë mbetje arkeologjike dhe kjo është vërtetuar në praktikë nga gërmimet për ndërtimin e centralit. Sa u përket pikave arkeologjike të Kepit të Terportit/Aulonës, Orikumit, Kështjellës së Kaninës dhe Kishës së Marmiroit, të gjitha këto ndodhen në një distancë të caktuar nga termocentrali, i cili, nga shumica e këtyre pikave, nuk duket. Në asnjërën prej këtyre pikave nuk do të kalojnë rrugë, naftësjetillës apo linja transmetimi. Kërkuessit apo Paneli nuk kanë cituar asnjë informacion provues se turistët nuk do të shkojnë në këto pika me vlera historike për shkak të afërsisë së tyre me vendndodhjen e TEC-it. Ekipi Drejtues beson se më shumë se ekzistenca e një centrali elektrik në rrethina, në numrin e vizitave të turistëve ndikojnë faktorë të tillë si lidhja me rrugë, përmirësimi i vendit dhe ekzistenca e shërbimeve të tilla si udhërrëfyesit, muzetë apo librat informues.

Vlerësimi Social

60. Paneli konstatoi se “një e metë në punën e Bankës për Projektin ishte mungesa e një vlerësimi social gjatë vlerësimit të Projektit.”²⁵ Vlerësimi i efekteve sociale kërkohet nga PO 4.01, e cila thotë se gjatë vlerësimit të korrektësisë duhet të merren në konsideratë efektet dhe shanset sociale, duke përdorur plane veprimi mjedisore dhe sociale. Përkufizimi i mjedisit i përfshin tërësisht efektet dhe shanset sociale, si një element kyç në VNM. Në kuadër të procesit të VM-së, Ekipi Drejtues beson se është thelbësore të realizohet një punë kërkimore dhe konsultime sociale adekuate, të mbështetura me dhënie publike të informacioneve, të cilat janë të nevojshme për të evidentuar dhe administruar çështjet e efekteve sociale dhe shanset për zhvillim që lindin nga investimet.

61. Sipas mendimit të Ekipi Drejtues, çështjet sociale nuk perceptoheshin si një tipar i fuqishëm i investimit, gjatë procesit të VM-së në vitin 2003, sepse TEC-i nuk ndodhej në një zonë të banuar por në një vendndodhje relativisht të izoluar, mbrapa një plazhi jo të zhvilluar, 6 kilometra larg Vlorës (shih Kutinë 3). Nuk dukej se kishte ndonjë dallim të madh mes grupeve të palëve të interesuara apo dallime etnike apo klasore lidhur me centralin. Ekzistonte një miratim i përgjithshëm se Shqipërisë i duhej ta zmadhonte kapacitetin e prodhimit të energjisë dhe t’i diversifikonte burimet energjetike. Në pamje të parë, nuk kishte asnjë grupim social i cili të kishte lidhje me çështjen e gjetjes së

²⁴ Raport i investigimit, para. 224.

²⁵ Raport i investigimit, para. 227.

vendndodhjes së termocentralit. Të vetmit përdorues të konsiderueshëm të zonës ishin peshkatarët dhe vendasit që bëjnë plazh në afërsi të vendndodhjes së termocentralit.

62. Megjithëse ka justifikime të mira ekonomike dhe teknike për vendndodhjen e centralit, nëse do të ishin bërë konsultime më të gjera në fillim të përgatitjes së Projektit mund të ishin evidentuar dallimet brendapërbrenda opinionit publik lidhur me centralin dhe ndërtimin e tij në Gjirin e Vlorës dhe, mbase, mund të ishte evidentuar kundërshtimi lidhur me të. Nëse do të kishte konsultime më të gjera, atëherë do të ishin evidentuar edhe një gamë më e gjerë e vizioneve dhe aspiratave të palëve të interesuara lokale për Vlorën. Mirëpo, këto dolën në dritë vetëm në janar 2005, pas rreth dhjetë muajsh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Projektit dhe shumë kohë pas mbylljes së procesit të VM-së. Ekipi Drejtues e pranon se këto çështje që dolën pas VNM-së do të ishin administruar më mirë nëse Projekti do të kishte një zë për informim dhe punë afruese me publikun.

63. Konsultimi dhe pjesëmarrja e publikut, të cilat i kërkon PO 4.01, duhet të kishin mjaftuar për identifikimin e çështjeve që shqetësonin banorët lokalë. Ka të ngjarë që konsultimet e realizuara në 2002 dhe 2003 të mos i kenë përfshirë disa prej palëve të interesuara përkatëse, të cilat, më vonë, shprehën kundërshtimin e tyre për strukturimin e Projektit. Parë nga tani, gjatë vitit 2005, kur lindi për herë të parë kundërshtimi për Projektin, gjëja e duhur mund të kishte qenë sjellja e një sociologu në terren për të matur situatën sociale dhe opinionet e ndryshme publike lidhur me Projektin.

Kutia 3. Vendndodhja e TEC-it

Edhe pse turizmi është i rëndësishëm për Vlorën, në plazhin mbrapa të cilit ndodhet TEC-i nuk ka komplekse pushimi apo hotele të përhershme. Bëhet fjalë për një rrip plazhi ranor, me ujë të cekët dhe shumë pak dallgëzim. I vetmi objekt që ndodhej në pjesën e përparme të plazhit, pranë TEC-it, ishte një uzinë e braktisur ku prodhohej sodë kaustike, e cila sot përbëhet nga objekte betoni të shkatërruara, duke qenë kështu një relikte e ndotur e periudhës së komunizmit. Mbrapa plazhit ndodhet një pishnajë e mbjellë përpara rreth 40 vjetësh.

Sot, ka një numër të vogël (rreth dhjetë) objekteve për turistë lokalë, të cilat janë kioska dhe platforma të vogla mbi të cilat janë vendosur karrige plazhi. Tani, plazhi pranë TEC-it frekuentohet kryesisht nga familjet lokale të cilat vijnë me vetura, biçikleta apo më këmbë, dhe që ushqimet, pijet dhe pajisjet i sjellin vetë.

Bëhet fjalë për një plazh tërësisht të ndryshëm nga plazhet në jug të Vlorës, të cilët karakterizohen nga ujëra të thella, hotele me bare moderne, karrige plazhi, çadra, etj., të vendosura për rehatinë e turistëve. Mbase do të vijë një ditë që sipërmarrësit do të vendosin të ndërtojnë në këtë plazh hotele apo veprimtari të tjera të lidhura me turizmin, mirëpo, deri tani, të gjithë hotelet në zonën e Vlorës ndodhen ose brenda në qytet ose përgjatë bregdetit në jug të qytetit.

Ndërtimi i TEC-it është thuajse i përfunduar dhe plazhi përpara tij do të kthehet siç ishte më parë. Centrali ndodhet 300 metra larg ujit dhe tubacionet e groposura të ujit dhe naftës shkojnë shumë larg bregut dhe nuk do të pengojnë notimin në det dhe përdorimin e plazhit.

64. Paneli ia hedh fajin Bankës që nuk ka kryer një “vlerësim të rreziqeve sociale” dhe, lidhur me këtë, citon DMP 2.20. DMP 2.20 jep udhëzime të dobishme lidhur me vlerësimin e projekteve të investimeve, përfshirë edhe një rubrikë për “Aspektet sociologjike”, e cila fillon kështu, “Aspektet sociologjike të projekteve ... janë sidomos të

rëndësishme për projektet e strukturuar për të asistuar përfitues të veçantë dhe/ose projektet suksesi i të cilëve varet nga pjesëmarrja e përfituesve... Ato mund të jenë më pak të rëndësishme për projektet që kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturë apo për disa projekte të cilat kanë relativisht më pak rëndësi.”²⁶ (theksi është shtuar këtu). Në përgatitjen e këtij Projekti dhe mbështetur në orientimin e DMP 2.20 dhe në praktikën e Bankës, Ekipi Drejtues beson se procesi i VM-së ishte i mjaftueshëm për të identifikuar efektet sociale të rëndësishme.

65. **Veprimet e Bankës.** Ekipi Drejtues po punon me KESH-in për të rritur angazhimin me banorët e Vlorës. Në këto veprimtari mund të përfshihen: (i) krijimi i një këshilli konsultativ me qytetarët; (ii) marrja e një specialisti për punën afruese; dhe (iii) hartimi i programeve të punës afruese, siç janë vizitat studentëve dhe nxënësve në termocentral. Pritet të dalë një projekt-plan angazhimi brenda datës 30 tetor 2009, ndërsa plani përfundimtar pritet të dalë brenda datës 30 dhjetor 2009.

66. Ekipi Drejtues është i angazhuar për fuqizimin e vlerësimit të aspekteve sociale dhe kulturore të investimeve përmes zbatimit të politikës së VM-së si edhe të politikave sociale dhe operative të lidhura. Lidhur me të ardhmen, Ekipi Drejtues do të punojë të kujdeset që: (1) efektet e rëndësishme sociale të identifikohen në fillim të studimit të korrektësisë nga Banka; (ii) të administrohen efektet negative dhe të zhvillohen shanset sociale; dhe (iii) Banka t’i mbikëqyrë këto aspekte gjatë gjithë ciklit të Projektit. Për këtë qëllim, Ekipi Drejtues po sqaron ndarjen e punës dhe përgjegjësi të stafit teknik social dhe mjedisor lidhur me vlerësimin e korrektësisë dhe mbikëqyrjen dhe kjo pritet të mbarojë brenda muajit mars 2010.

67. Lidhur me konsultimet dhe dhënien e informacioneve publike, do t’u ngarkohet specialistëve socialë të kujdesen që cilësia, objekti dhe shpeshësia e konsultimeve publike të jenë adekuate dhe të dokumentuara mirë. Lidhur me këtë, tani shpejt, do të fillojë trajnimi i rregullt i stafit të zhvillimit social. Ekipi Drejtues vëren gjithashtu se përmirësimi i vlerësimit të efekteve sociale të projekteve është njëra prej masave për Rajonin e EAQ-së, pas shqyrtimit që i bëri Bordi Raportit të Inspektimit për Projektin e Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare në Shqipëri. Ekipi Drejtues do të kujdeset që fuqizimi institucional në këtë aspekt të bëhet edhe për projektet e mëdha të infrastrukturës dhe energjisë, për ta rritur edhe më shumë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre në kohë.

Konsultimet, Pjesëmarrja dhe Dhënia e Informacionit

68. Qeveria zhvilloi tri konsultime publike për TEC-in. Konsultimi i parë, në fund të muajit tetor 2002, u përqendrua te rezultatet e studimit për vendndodhjen dhe i parapriu vendimit të Bankës për të filluar me përgatitjen zyrtare të Projektit. Sipas artikujve të gazetave, në këtë konsultim u përfshinë zyrtarë lokalë dhe rajonalë, akademikë, organizata joqeveritare (OJQ), intelektualë dhe persona të tjerë. Gjatë diskutimit, u ngritën çështje të lidhura me teknologjinë, efektet lokale dhe vendndodhjet alternative.

²⁶ Manual operativ – DMP 2.20, ndryshuar në 2004, para. 55.

69. Pas kësaj, VNM-ja e Projektit e përmbushi kërkesën për dy faza konsultimi, e cila parashikohet në PO 4.01: në fazën e hershme (termat e referencës për VNM-në) dhe, më pas, në fazën e projekt-raportit të VNM-së. Këto konsultime u realizuan, përkatësisht, më 2 prill 2003 dhe 3 shtator 2003. Sikurse vërehet në grafikun kohor që përshkruhet në Raportin e Investigimit, VNM-ja iu bë publik palëve të interesuara duke filluar qysh më 23 korrik 2003 (projekt-raporti), i cili u ndoq nga bërja publik e VNM-së përfundimtare dhe nga Shtojca e VNM-së në janar 2004. Fundi i periudhës së publikimit për BERZH-in, për të njëjtat dokumente të VNM-së, ishte data 7 qershor 2004. Ekipi Drejtues e pranon se Termat e Referencës për konsultimin e muajit prill 2003 për VNM-në u shpërndanë jo më parë se koha e mbledhjes dhe se kjo është një e metë. Lidhur me konsultimin e muajit shtator 2003, Ekipi Drejtues vëren se projekt-dokumenti u bë publik në disa vende publike, përpara zhvillimit të mbledhjes, dhe se, pas kësaj, janë bërë përditësime në kohë. Ky konsultim u zhvillua dy muaj përpara datës së Vlerësimit të Projektit (10 nëntor 2003) dhe gjashtë muaj përpara prezantimit përpara Bordit. Njoftimi për shtyp për Projektin e miratuar u qarkullua gjerësisht. Ekipi Drejtues beson se periudha e gjatë e bërjes publike të VNM-së së Projektit dhe mbulimi i gjerësishtëm i Projektit të TEC-it në media, gjatë kohës kur kishte edhe ndërprerje të energjisë elektrike, ofronte një sërë mundësish për palët e interesuara, që këto të fundit të njiheshin me projektin dhe të merrnin dokumentacionin.

70. Kundërshtimet publike për Projektin lindën rreth kohës kur hyri në fuqi (filloi) Projekti. Ekipi Drejtues iu përgjigj me drejtësi dhe korrektësi çdo kërkesë me shkrim. Sikurse thuhet edhe gjetkë, Banka kreu një mision të specializuar në përgjigje të shqetësimeve të ngritura për pasurinë kulturore.

71. Për të përgatitur këtë Raport të Ekipit Drejtues, Banka zhvilloi një mision në Shqipëri në gusht-shtator 2009. Ky mision pati mundësinë të takohej me anëtarët e tetë OJQ-ve të ndryshme lokale. Në këto takime, stafi i Bankës pyeti se përse protestat kundër TEC-it të Vlorës u regjistruan pranë Ekipit Drejtues jo më herët se viti 2005, edhe pse VNM-ja e Projektit ishte bërë publik dhe ishte vendosur në internet dhe ishte i gatshëm në formë të shtypur dhe ishte pasqyruar në shtyp qysh në vitin 2003. Disa përfaqësues të OJQ-ve në Vlorë thanë se informacionin për Projektin e kishin marrë jo më parë se viti 2005.

72. Përfaqësuesit e OJQ-ve ofruan shpjegime të ndryshme për vonesën në mobilizimin e shoqërisë civile. Sipas njërit prej tyre, shoqëria civile mund të kishte pasur frikë nga angazhimi me qeverinë. Sipas një tjetri, shoqëria civile ishte “e papjekur” dhe e pamësuar për të vepruar për çështje që e shqetësojnë publikun. Bankwatch (2008)²⁷ në studimin e vet për kundërshtimin ndaj terminalit të naftës Petrolifera, që ndodhet pranë, thoshte se shoqëria civile u tregua e ngadaltë për të reaguar për shkak të natyrës shumë teknike të materialeve që kishin në dispozicion. Është e pranueshme që organizatat e shoqërisë civile nuk ishin të mobilizuara mjaftueshëm për të marrë informacion dhe për të vepruar në bazë të këtij informacioni. Sipas Bankwatch (2008)²⁸, “*reagimi lokal ndaj*

²⁷ http://bankwatch.org/documents/FFM_vlora_report.pdf (marrë më 2 shtator 2009)

²⁸ E njëjta.

projektit filloi në Vlorë në 2004 dhe u zyrtarizua me krijimin e Aleancës Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës ... në mars 2005.” Kur, më në fund, lindën edhe protestat, ato ndodhën në kuadër të zgjedhjeve të përgjithshme, të zhvilluara me një betejë politike të ashpër (të mbajtura më 3 korrik 2005). Kundërshtimi ndaj zhvillimit të gjerë industrial në Vlorë u shndërrua në moton e njërës prej partive politike, një faktor i cili mund të ketë ndihmuar në rritjen e protestave publike. Kundërshtimi publik ndaj TEC-it lindi rreth dhjetë muaj pas miratimit të Projektit nga Bordi (16 mars 2004), kur disa organizata të shoqërisë civile filluan të mobilizohen kundër zhvillimit industrial në Vlorë, në përgjithësi, dhe, në veçanti, lidhur me terminalin e naftës Petrolifera. E thënë shkurt, kundërshtimi ndaj termocentralit u ndikua nga faktorë që shkonin përtej vetë termocentralit.

73. Mirëpo, stafi i Bankës vërejti gjatë misionit të periudhës gusht/shtator 2009 se kundërshtimi ndaj TEC-it nuk është i përgjithshëm dhe se disa prej palëve të interesuara i kanë ndryshuar pikëpamjet e tyre. Disa banorë dhe përfaqësues biznesesh, me të cilët diskutoi stafi, theksuan mungesat e energjisë elektrike në Vlorë dhe efektet negative të këtyre ndërprerjeve, të cilat zgjasin deri në 13 orë në disa ditë të muajve të fundit, si për turizmin ashtu edhe për biznesin në përgjithësi. Disa të tjerë, sidomos ata të cilët kanë shkuar për ta parë centralin, kishin fjalët më të mira për teknologjinë e fjalës së fundit, të cilën ata e shihnin si përfaqësuese të modernizimit të Shqipërisë. Ata që panë pajisjet për parandalimin e rrjedhjeve të naftës në perimetrin e centralit u impresionuan pozitivisht. Megjithatë, disa persona vijuan të shprehin pakënaqësi për ndërtimin e centralit në afërsi të plazhit.

74. **Konventa e Arhusit.** Ekipi Drejtues vëren se Përgjigja e tij për Kërkesën për Inspektim doli më 1 qershor 2007, përpara se Komiteti i Zbatimit të Konventës së Arhusit të bënte të ditur konstatimet e tij për zbatimin e Konventës së Arhusit nga Shqipëria lidhur me vendimet për vendndodhjen e TEC-it dhe të objekteve të tjera (domethënë, të terminalit të depozitimit të naftës, infrastrukturës portuale dhe naftës-jellësit dhe gazsjellësit) në Vlorë. Edhe pse Banka nuk është Palë e Konventës²⁹, fokusi te “*liria e informimit, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje dhe liria për drejtësi në çështjet mjedisore*” supozohej se kishte rrjedhoja edhe për zbatimin e politikës së Bankës për konsultimet dhe dhënien e informacionit. Banka iu përgjigj kërkesave për informacion të Komitetit përpara se ky i fundit të nxirrte raportin e tij dhe me kënaqësi vërejti njohjen e asistencës së ardhshme të Bankës për Shqipërinë, lidhur me Zbatimin e Konventës së Arhusit, asistencë e cila ende vazhdon.

75. Një element i rëndësishëm i Konstatimeve dhe Rekomandimeve të Komitetit të Zbatimit (të nxjerra më 31 korrik 2007), i cili ritheksohet edhe në Raportin e Investigimit, ka të bëjë me faktin nëse kishte apo angazhim publik të mjaftueshëm gjatë procesit të përzgjedhjes së vendndodhjes në vitin 2002 dhe, më pas, gjatë procesit zyrtar të VNM-së të Projektit. Në konsideratë të konstatimeve të Komitetit, si edhe të Raportit të

²⁹ Ekipi Drejtues vëren konstatimet e Panelit, të cilat mbështeten në konstatimet e Komitetit të Zbatimit të Konventës së Arhusit, i cili, në bazë të Nenit 15 të Konventës së Arhusit, ka një “natyrë jokonfrontuese, jogjyqësore dhe këshillimore”. Duke qenë se Paneli nuk e ka shprehur bazën për përfundimet e tij lidhur me moszbatimin, në këtë çështje, përveç përmendjes së konstatimeve të Komitetit të Zbatimit të Konventës së Arhusit, ky Raport është përpjekur t’u përgjigjet pikave të ngritura nga Komiteti.

Investigimit, Ekipi Drejtues pranon mangësi të mundshme lidhur me angazhimin e kuptim të me publikun, gjatë procesit të përzgjedhjes së vendndodhjes, të cilat penguan: (i) një njohje të mirë të këndvështrimeve të shoqërisë lidhur me vendndodhjet alternative dhe me kriteret për vendndodhjen; (ii) marrjen e mendimeve të banorëve të zonës së Vlorës lidhur me vendndodhjen e preferuar në komunitetin e tyre; (iii) një diskutim më të plotë të alternativave në VNM-në e Projektit. Staf i Bankës nuk e nxiti Qeverinë e Shqipërisë të këqyrte vendndodhje të tjera të mundshme, krahas vendndodhjes në Vlorë, që ishte tashmë e preferuara, dhe kjo qasje u pranua nga Qeveria në studimin për vendndodhjen dhe studimin e realizueshmërisë.

76. Ekipi Drejtues i pranon shqetësimet e Komitetit të Zbatimit të Arhusit lidhur me dokumentimin për ftesat dhe njoftimet për dy konsultimet për VNM-në e Projektit (prill dhe shtator 2003), mirëpo gjithashtu thekson periudhën e gjatë të bërjes publike të dokumenteve të VNM-së, të përmendur më lart, e cila, të paktën, duhet të ketë zbutur disa prej këtyre mangësive të pranuar. Ekipi Drejtues vëren, gjithashtu, se Njoftimi për Shtyp lidhur me miratimin e Projektit nga Bordi u përmend gjerësisht nga mediat kombëtare, e megjithatë kundërshtimi për Projektin doli vetëm pas thujse një viti.

77. Sa i takon rolit të Bankës lidhur me zbatimin e Konventës së Arhusit, ndërkohë që Komiteti konstatoi mangësi në zbatimin e disa dispozitave të Konventës së Arhusit nga Qeveria e Shqipërisë, Banka i qëndron mendimit se ajo nuk *“ka financiar veprimtari projekti që do të binin ndesh me detyrime të tilla të Shqipërisë, sikurse është identifikuar gjatë VM-së”*, çka është një element kyç i PO 4.01, para. 3. Ekipi Drejtues vëren se në kohën e përgatitjes së Projektit mungonte orientimi specifik që IFN-të t’i mbështetin vendet partnere në përmbushjen e detyrimeve të Konventave të Komisionit Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara (UNECE), përfshirë edhe Konventën e Arhusit, dhe ky orientim ende pritet të dalë. Kjo mungesë orientimi praktik është konstatuar si një pengesë për rolin e BERZH-it në mbështetje të Shqipërisë, nga shqyrtimi i Mekanizmit të Shqyrtimit të Brendshëm (prill 2008)³⁰ lidhur me pjesën e BERZH-it në financimin e TEC-it të Vlorës.

78. Ekipi Drejtues dëshiron të vërejë disa zhvillime të kohëve të fundit, lidhur me zbatimin e Arhusit nga ana e Shqipërisë, në përgjigje të raportit të vitit 2007 të nxjerrë nga Komiteti i Zbatimit. Shqipërisë i është kërkuar të paraqesë raporte progresi vjetore, ku i fundit prej këtyre raporteve duhej të dilte në nëntor 2008. Një raport i datës 30 janar 2009 u paraqit për shqyrtim pranë Komitetit të Zbatimit në mbledhjen e këtij Komiteti të datës 31 mars-3 prill 2009. Megjithëse shprehte keqardhje për vonesën e raportit të progresit të Shqipërisë për përmirësimin e zbatimit të Konventës, *“Komiteti shprehte kënaqësinë e tij të përgjithshme për përmbajtjen e raportit, i cili pasqyrore punën që kishte sjellë një progres të konsiderueshëm.”*

79. Njëra prej masave për Shqipërinë ishte përmirësimi i kuadrit të saj rregullator mjedisor (domethënë, shtesa, ndryshime dhe plotësime në ligjet mjedisore ekzistuese apo hartimi i ligjeve të reja) për t’i harmonizuar ato me dispozitat e Konventës së Arhusit. Pas miratimit të ligjit të ri nr 8934, datë 09.05.2002, *“Për mbrojtjen e mjedisit”*, i cili një

³⁰ Po aty; Raporti i BERZH-it, paragrafi 119 pikat (iii) dhe (v).

kapitull ia kushton vlerësimin të ndikimit mjedisor, u miratuan dy ligje të reja, Ligji nr 8990, datë 23.01.2003, “Për vlerësimin e ndikimit mjedisor” dhe Ligji Nr 9424, datë 10.06.2005, “Për ratifikimin e Protokollit për Vlerësimin Mjedisor Strategjik”. Në përputhje me kërkesat e Konventës së Arhusit dhe Direktivat e BE-së, janë miratuar edhe aktet e mëposhtme:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr 994, datë 02.07.2008, “Për tërheqjen e opinionit publik në vendimmarrjen mjedisore”, i cili përcakton procedurat për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e VNM-ve dhe hartimin e akteve ligjore dhe strategjive.
- Dy rregullore ministrore, përkatësisht Rregullorja Nr 1, datë 17.08.2004, “Për pjesëmarrjen publike në procesin e VNM-ve” dhe Rregullorja Nr 1, datë 03.03.2009, “Për detyrimet e organeve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të OJQ-ve në procesin e VNM-ve”. Objektivi i Rregullores për Pjesëmarrjen e Publikut është të përcaktojë rregullat dhe procedurat e detyrueshme që garantojnë pjesëmarrjen e publikut në procesin e VNM-ve, ndërsa objektivi i Rregullores për Organet Mjedisore është të përcaktojë rolet e agjencive rajonale të mjedisit, Drejtorisë së VNM-së dhe Lejeve Mjedisore dhe Komisionit të Shqyrtimit të Lejeve pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për të siguruar pjesëmarrjen e publikut të prekur në procesin e realizimit të VNM-ve dhe dhënies së lejeve.

80. Ligji i ri “Për planifikimin e territorit”³¹, i cili është mbështetur nga një sërë donatorësh (Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës, Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara dhe Banka Botërore), si përmes një dialogu për huadhënien e mbështetur te politikat ashtu edhe përmes një projekti investimi, shënon një përparim të ndjeshëm lidhur me mënyrën se si do të administrohet në të ardhmen rregullimi i territorit në Shqipëri. Ky ligj i ri përmban përmirësime të mëdha në fushën e transparencës, dhënies së informacioneve dhe konsultimit me publikun. Ligji e përmirëson ndjeshëm njoftimin e publikut lidhur me masat planifikuese që po merren në shqyrtim. Një prej elementeve të spikatura të ligjit të ri është krijimi i një “Regjistri Planifikimi” në internet, krahas mjeteve konvencionale të komunikimit, përmes të cilave i jepet informacion publikut. Ligji e krijon regjistrin si vendin ku pushteti vendor, rajonal dhe qendror publikojnë vendimet e propozuara dhe të miratuara të rregullimit të territorit. Këtu përfshihen planet e reja të rregullimit të territorit, kërkesat për leje ndërtimi, miratimet e këtyre lejeve dhe masat kombëtare që lidhen me rregullimin e territorit. Krahas kësaj, ky ligj parashikon një kuadër të qartë për funksionet e rregullimit të territorit në nivel qendror dhe vendor. Ai i jep një kompetencë të konsiderueshme për rregullimin e territorit dhe kontroll mbi ndërtimin pushtetit vendor dhe, kështu, më në fund e harmonizon sistemin e rregullimit të territorit me legjislacionin e decentralizimit në Shqipëri dhe me parimin e subsidiaritetit të BE-së.

³¹ Citohet zyrtarisht si Ligji Nr 10119, datë 23.04.2009, “Për planifikimin e territorit”. Teknikisht, ky ligj ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr 56 (botuar më 8 maj 2009) edhe pse zbatimi i plotë do të fillojë më shtator 2010, kur të shfuqizohet plotësisht Ligji Nr 8405, datë 16.09.1998, “Për urbanistikën”.

81. Gjatë kësaj kohe, në kuadër të projektit të financuar nga programi CARDS i BE-së për vënien në zbatim të planit kombëtar të përafrimit të legjislacionit mjedisor, janë në fazat e fundit të përgatitjes tri ligje të reja: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për VNM-në dhe Ligji për Lejet Mjedisore, në përputhje me Direktivën IPPC. Këto tri ligje përmendin në mënyrë të dallueshme procedurat e informimit dhe pjesëmarrjes së publikut për VNM-të, si edhe ricaktimin e roleve të agjencive në këtë proces.

82. **Veprimet e Bankës për të Ndrejur Mangësitë.** Ekipi Drejtues vëren se Banka i është përgjigjur ftesës së Komitetit të Zbatimit të Konventës së Arhusit “*për t’i dhënë këshilla dhe asistencë Palës*” (domethënë, Shqipërisë) lidhur me përmirësimin e zbatimit të Konventës. Banka ka miratuar një projekt të kuadër të Fondit të Zhvillimit Institucional (FZHI) me vlerë 370.000 dollarë amerikanë, në formë granti, për *Fuqizimin e Zbatimit të Konventës së Arhusit nga Shqipëria*,³² i cili do të fillojë në shtator 2009 dhe do të mbështetet në punën e ngjashme që ka Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Objektivat për zhvillim të FZHI-së janë:

- Ngritja dhe/ose përmirësimi i kapacitetit të Qendrës së Arhusit, agjencive rajonale mjedisore, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara, për t’i kuptuar kërkesat ligjore të Konventës së Arhusit dhe për të vënë në zbatim strategjinë dhe planin e veprimit të Shqipërisë për Konventën e Arhusit;
- Rritja e ndërveprimit midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike lidhur me pjesëmarrjen e publikut dhe lirinë për drejtësi në vendimmarrjen shtetërore lidhur me çështjet mjedisore kombëtare dhe ndërkufitare, duke nxitur zbatimin e përmirësuar të dispozitave përkatëse të Konventës; dhe
- Përmirësimi i rolit mbikëqyrës të shoqërisë civile, përmes angazhimit të saj në mënyrë konstruktive në proceset planifikuese të qeverisë të lidhura me mjedisin, përmes monitorimit të përmirësuar të udhëzimeve dhe kërkesave që parashikon Konventa.

83. Banka do të vazhdojë ta mbështesë Qeverinë e Shqipërisë në projektin e mbështetur nga FZHI, i cili do të vazhdojë edhe gjatë vitit fiskal 2011. Krahas kësaj, Banka do të përgatisë dhe realizojë në pranverë 2010 një modul trajnimi për stafin e Bankës që asiston qeveritë partnere që këto të fundit t’i përmbushin detyrimet e tyre në kuadër të traktateve ndërkombëtare, duke përfshirë edhe zbatimin në praktikë (me udhëzime të shkruara) të dy konventave të UNECE-së (Arhusit dhe Espo).

IV. PLANI I VEPRIMIT I EKIPIT DREJTUES NË PËRGGJIGJE TË KONSTATIMEVE

84. Sa më lart, Ekipi Drejtues ka përgatitur një plan veprimi (shih Tabelën 1, më poshtë), për të trajtuar çështjet kyçe, sidomos kundërpërgjigjen ndaj rrjedhjeve të naftës, monitorimin mjedisor, analizën e çështjeve sociale dhe komunikimin. Një mision i Bankës Botërore i ka diskutuar karakteristikat e përgjithshme të Planit të Veprimit me

³² Kontrata e grantit do të bëhet e ditur kur të nënshkruhet zyrtarisht nga qeveria e re e Shqipërisë.

Kërkuesit dhe me organizata të tjera të interesuara të shoqërisë civile, në fillim të muajit shtator 2009.

85. Banka është takuar edhe me Qeverinë e re për të diskutuar për elementet kyçe të planit të propozuar të veprimit, më 14 shtator 2009. Ndërkohë që Qeveria ka rënë dakord me elementet kyçe, përpara diskutimit të Bordit do të jepet edhe një përditësim i tij.

86. Ekipi Drejtues do t'i japë një përditësim Bordit gjashtë muaj pas shqyrtimit të këtij Raporti dhe Rekomandimeve të Ekipit Drejtues nga ana e Bordit.

Tabela 1. Plan i propozuar veprimi i Ekipit Drejtues	
ÇËSHTJA	VEPRIMI
Vlerësimi Mjedisor dhe Masat Zbutëse	
Mjedisi Detar – Kundërpërgjigja ndaj Rrjedhjeve të Naftës	Duke qenë se nuk është ende tërësisht i gatshëm Plani i Kundërpërgjigjes ndaj Rrjedhjeve të Naftës në det, Banka do të mbikëqyrë përfundimin e këtij plani përpara futjes në shfrytëzim rutinë të objektit (çka mendohet, hë për hë, se do të ndodhë në fillim të muajit nëntor 2009), siç e kërkon edhe Kontrata e Kredisë.
Cilësia e Ajrit dhe Ujit	Ekipi Drejtues do të raportojë për progresin që ka arritur KESH-i lidhur me monitorimin në rregullsi të parametrave mjedisorë që lidhen me operacionet e Projektit, së bashku me bërjen publike të informacioneve përkatëse të monitorimit.
Analiza Sociale	<p>Ekipi Drejtues do ta nxisë fuqimisht KESH-in për të rritur angazhimin me banorët e Vlorës. Në këto veprimtari mund të përfshihen: (i) krijimi i një këshilli konsultativ me qytetarët; (ii) marrja e një specialisti me kohë të plotë për punën afruese; (iii) hartimi i programeve të punës afruese, siç janë vizitat e studentëve dhe nxënësve në termocentral. Pritet të dalë një projekt-plan angazhimi brenda datës 30 tetor 2009, ndërsa plani përfundimtar pritet të dalë brenda datës 30 dhjetor 2009.</p> <p>Ekipi Drejtues është i angazhuar për fuqizimin e vlerësimit të aspekteve sociale dhe kulturore të investimeve përmes zbatimit të politikës së VM-së si edhe të politikave sociale dhe operative të lidhura. Lidhur me të ardhmen, Ekipi Drejtues do të punojë të kujdeset që: (1) efektet e rëndësishme sociale të identifikohen në fillim të studimit të korrektësisë nga Banka; (ii) të administrohen efektet negative dhe të zhvillohen shanset sociale; dhe (iii) Banka t'i mbikëqyrë këto aspekte gjatë gjithë ciklit të Projektit. Për këtë qëllim, Ekipi Drejtues po sqaron ndarjen e punës dhe të përgjegjësiive të stafit teknik social dhe mjedisor, lidhur me vlerësimin e korrektësisë dhe mbikëqyrjen. Kjo pritet të përfundojë brenda muajit mars 2010.</p> <p>Lidhur me konsultimet dhe dhënien e informacioneve publike, do t'u ngarkohet specialistëve socialë detyra që të kujdesen që cilësia, objekti dhe shpeshësia e konsultimeve publike të jenë adekuate dhe të dokumentuara mirë. Lidhur me këtë, në dy muajt në vijim, do të fillojë trajnimi i rregullt i stafit të zhvillimit social.</p>

Tabela 1. Plan i propozuar veprimi i Ekipit Drejtues	
ÇËSHTJA	VEPRIMI
Detyrimet mjedisore ndërkombëtare në bazë të PO 4.01	<p>Banka do të vijojë mbështetjen për Qeverinë e Shqipërisë në kuadër të projektit të ngritjes së kapaciteteve “Fuqizimi i Zbatimit të Konventës së Arhusit”, mbështetur nga FZHI-ja, i cili do të vazhdojë edhe gjatë gjithë vitit fiskal 2011.</p> <p>Banka do të përgatisë dhe realizojë, në pranverë 2010, një modul trajnimi për stafin e Bankës për asistimin e qeverive partnere që këto të fundit t’i përmbushin detyrimet e tyre në kuadër të traktateve ndërkombëtare, duke përfshirë edhe zbatimin praktik (me udhëzime me shkrim) të dy Konventave të UNECE-së (Arhusi dhe Espo).</p>
Pasuria Kulturore	Banka do të vijojë mbikëqyrjen e Projektit për çdo gjetje të rastësishme të pasurive kulturore gjatë gjithë kohës, deri në mbyllje të Projektit.
Konsultimet dhe Dhënia e Informacionit	
Zbatimi i Konsultimeve Publike gjatë gjithë vënies në zbatim të Projektit	<p>Ekipi Drejtues vëren se përmirësimi i vlerësimit të efekteve sociale të projekteve është njëra prej masave për Rajonin e EAQ-së, pas shqyrtimit që i bëri Bordi Raportit të Inspektimit për Projektin e MIZB-së në Shqipëri. Ekipi Drejtues do të kujdeset që fuqizimi institucional në këtë aspekt të bëhet edhe për projektet e mëdha të infrastrukturës dhe energjisë, për ta rritur edhe më shumë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre në kohë (kjo masë është në zbatim).</p> <p>Duke filluar në muajin tetor 2009, Ekipi Drejtues do të vërë në zbatim një Strategji të ndryshuar për Komunikim të Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, Shqipëri. Ndër të tjera, strategjia e re përfshin: (i) një sistem për përgjigje parapr tëse dhe me afate kohore kundrejt ankesave të ardhura nga komuniteti, shoqëria civile dhe sektori privat; (ii) rritje të mbikëqyrjes së proceseve të konsultimeve të udhëhequra nga qeveria gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve; dhe (iii) seanca vjetore informimi për komisionet përkatëse parlamentare në lidhje me zbatimin e projekteve dhe çështjet e reformave të politikave.</p>

V. PËRFUNDIM

87. Ekipi Drejtues beson se ekipi i Bankës i ka bërë të gjitha përpjekjet për t’i zbatuar politikat dhe procedurat e saj dhe për të përmbushur misionin e saj, në kuadër të Projektit. Ekipi Drejtues i vëren konstatimet e Panelit dhe është i angazhuar për përmbushjen e Planit të Veprimit të Ekipit Drejtues dhe për ndjekjen e vënies së tij në zbatim. Ekipi Drejtues beson se Plani i propozuar i Veprimit, që i bashkëlidhet përgjigjes së tij, u jep zgjidhje shqetësimeve të Panelit.

ANEKSI 1
KONSTATIME, KOMENTE DHE VEPRIME

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
ZBATIMI I KËRKESAVE MJEDISORE			
1.	<p>Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor</p> <p>Pas përfundimit të Studimit të Realizueshmërisë, Ministria Shqiptare e Industrisë dhe Energjetikës porositi të njëjtën firmë konsulente të kryente një Vlerësim të Ndikimit Mjedisor për vendndodhjen e përzgjedhur në Vlorë. Paneli konstaton se Ekipi Drejtues nuk ka siguruar zbatimin e kërkesave të PO 4.01, duke e lejuar Huamarrësit të përdorë të njëjtin konsulent që realizoi studimet për vendndodhjen dhe të realizueshmërisë, edhe për kryerjen e Vlerësimit Mjedisor të Projektit.</p>	114-129	<p>Koment: Ekipi Drejtues vëren konstatimin e Panelit të Inspektimit lidhur me moszbatimin e PO 4.01 për përdorimin e të njëjtës firmë konsulente për studimin e realizueshmërisë dhe për VNM-në. Ekipi Drejtues pajtohet me Panelin se është e dëshirueshme të ketë një veçim të VM-së nga projektimi, në mënyrë që të evitohet konflikti i mundshëm i interesit dhe, në të vërtetë, kjo është kthyer në normë për shumicën e projekteve të Kategorisë A. Në rastin e këtij Projekti ishte e nevojshme një qasje alternative, duke qenë se e gjithë asistenca përgatitore për Qeverinë e Shqipërisë po jepej në kuadër të një kontrate të financuar nga USTDA-ja dhe, në bazë të një qasjeje me kontratë PPN, realizimi i projektit teknik bëhet gjatë vënies në zbatim.</p> <p>Për asistencë në financimin e një shqyrtimi të pavarur të raportit të VNM-së, Banka iu drejtua Qeverisë së Kanadasë, e cila (përmes CIDA-s) kishte mbështetur punën sektoriale për furnizimin me energji në Evropën Juglindore. CIDA përzgjedhi një konsulent për të shqyrtuar projekt-raportin e VNM-së, i cili dha më pas komente në tetor 2003, në dymbëdhjetë fushat tematike, në funksion të fuqizimit të dokumenteve. Këto u morën parasysh nga Banka Botërore, BERZH-i dhe konsulenti i VNM-së dhe u pasqyruan si në VNM-në Përfundimtare në tetor 2003 ashtu edhe në një Shtojcë të muajit dhjetor 2003 (së bashku me VNM-në e Projektit) e cila përfshinte shqyrtime të tjera nga stafi i Bankës dhe i BERZH-it. Edhe pse Ekipi Drejtues pajtohet me komentin se ky proces i përsëritur nuk ishte optimal dhe do të përpiqet t'i minimizojë mënyra të tilla pune në të ardhmen, përdorimi i një firme të pavarur dhe i stafit nga të dy IFN-të u konsiderua i mjaftueshëm nga Ekipi Drejtues për të arritur qëllimet e PO 4.01 lidhur me evitimin e konfliktit të interesit. Ekipi Drejtues nuk ishte në dijeni të asnjë lidhjeje financiare apo teknike midis konsulentit të përzgjedhur nga CIDA dhe konsulentit që përgatiti VNM-në e financuar nga USTDA. Ekipi Drejtues e konsideronte përvojën e konsulentit të CIDA-s në fushën e sektorit energjetik të Evropës Juglindore si një avantazh të vlefshëm për realizimin e shqyrtimit të pavarur të VNM-së.</p> <p>Veprimi: Nëse Banka do të hasë një situatë të ngjashme të jashtëzakonshme ajo do të kërkojë një përrjashtim nga Bordi.</p>
2.	<p>Shqyrtimi i Alternativave Teknologjike</p> <p>Paneli konstaton se është vepruar drejt që nuk janë marrë më tej në konsideratë alternativat teknologjike jo të qëndrueshme, në Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor. Megjithëse diskutimi në Studimin e Përcaktimit të Vendndodhjes nuk përsëritet në Vlerësimin Përfundimtar Mjedisor, në të janë vlerësuar alternativat e duhura teknologjike për Projektin. Kjo është në përputhje me PO 4.01.</p>	131-132	<p>Koment: Ekipi Drejtues vëren konstatimin e Panelit për zbatimin e kërkesave.</p> <p>Veprimi: Nuk nevojitet asnjë veprim.</p>
3.	<p>Shqyrtimi i Alternativave të Vendndodhjes</p>	133-139	<p>Koment: Ekipi Drejtues e pranon konstatimin e Panelit të Inspektimit se Qeveria e Shqipërisë e përzgjedhi vendndodhjen për TEC-in (dhe investimet e lidhura me të) në vitin 2002,</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
	<p>Paneli konstaton se Vlerësimi Mjedisor, i cili përmban justifikim <i>post hoc</i> për përzgjedhjen e vendndodhjes, nuk dha asnjë kontribut në përmirësimin e përzgjedhjes, caktimit të vendndodhjes, planifikimit apo strukturimit të Projektit. Paneli vëren se, kështu, qëllimi i VM-së së Vlorës u kufizua vetëm me përmirësimin e vënies në zbatim të Projektit, pasi ishin marrë vendimet për të ecur përpara. Ky proces nuk është në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të PO 4.01.</p> <p>Paneli arrin në përfundimin se Ekipi Drejtues nuk e ka zbatuar paragrafin 5 të PO 4.01, duke pranuar studime të cilët nuk e kanë përmbushur qëllimin themelor të Politikës për Vlerësimet Mjedisore. Banka nuk nguli këmbë që të kryeshin studime të mëtejshme të bëra siç duhet, për të ndrequr mangësitë.</p>		<p>përpara se të niste Vlerësimi Mjedisor i hollësishëm për Projektin në 2003. Edhe pse Raporti i Investigimit konstaton mangësi në këtë qasje, lidhur me zbatimin e PO 4.01, Ekipi Drejtues mendon se angazhimi i Bankës gjatë kësaj faze, përpara Shqyrtimit të Konceptit, ishte konform praktikës së pranueshme dhe politikës së Bankës. Duke qenë se Banka kishte disa vjet që ishte partnere me Qeverinë e Shqipërisë për çështjet energjetike, gjatë vitit 2002 Banka i ka dhënë këshilla Qeverisë (dhe konsulentëve të saj) në mënyrë joformale, si një financuese e mundshme e TEC-it. Banka ishte në dijeni të parapëlqimit nga ana e Qeverisë së Shqipërisë për një TEC në Vlorë, si edhe të punës së konsulentëve të huaj të cilët po përgatisnin studimin e realizueshmërisë dhe studimin për vendndodhjen. Në kuadër të korrektësisë, Banka e nxitte Qeverinë të merrte në shqyrtim edhe vendndodhje të tjera alternative për TEC-in, krahas Vlorës. Ky rekomandim u pranua, sikurse pasqyrohet edhe në termat e referencës për konsulentin në prill 2002, dhe u ndoq edhe më pas në studimin për vendndodhjen, i cili u finalizua më 21 tetor 2002.</p> <p>Banka filloi ta përgatisë zyrtarisht Projektin me nxjerrjen e DIP-së më 2 janar 2003 dhe mbledhjen e brendshme për shqyrtimin e konceptit më 10 janar 2003. Fleta e parë me të dhënat për masat mbrojtëse të integruara të Projektit u hodh në InfoShop më 20 shkurt 2003, ku konfirmohej klasifikimi i VM-së i Kategorisë A. Mbledhja për shqyrtimin e konceptit erdhi pas miratimit të trualit në Vlorë B nga Këshilli i Rregullimit të Territorit i Vlorës më 21 dhjetor 2002 dhe menjëherë përpara miratimit nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit i Shqipërisë më 10 shkurt 2003, i vendndodhjes me vlerësimin më lartë (Vlorë B) që kishte dalë nga faza e realizueshmërisë/studimit për vendndodhjen.</p> <p>Ndërkohë që veprimet e Qeverisë së Shqipërisë gjatë procesit të përzgjedhjes së vendndodhjes, në vetvete, nuk ishin objekt i PO 4.01, Banka mendonte se qasja me shumë kritere, të cilën kishin ndjekur konsulentët e huaj për shtatë vendndodhjet alternative, ishte një praktikë e mirë. Banka e shqyrtoi me imtësi raportin e konsulentëve lidhur me këto vendndodhje dhe e konsideroi rekomandimin për Vlorë B si rekomandim të shëndoshë nga ana teknike. Banka ishte në dijeni të mbledhjes publike (të zhvilluar më 31 tetor 2002) që u organizua pas daljes së studimit përfundimtar për vendndodhjen, mirëpo Banka e pranon se do të kishte qenë i dëshirueshëm një konsultim më i hershëm me komunitetet që mund të prekeshin.</p> <p>Procesi i korrektësisë i Bankës konfirmoi se vendndodhja Vlorë B meritonte vlerësimin më të lartë dhe se mund të fillonte një VNM për Projektin, për të hetuar përshtatshmërinë e plotë të saj. Ekipi Drejtues e thekson se VNM-ja nuk ishte thjesht për të mbështetur përzgjedhjen e vendndodhjes Vlorë B, por për të vlerësuar rreziqet, për të përcaktuar masat e zbutjes së rrezikut dhe për t'u kujdesur që të plotësoheshin kërkesat e politikave të Bankës. Më pas, rezultatet e studimit për vendndodhjen (përfshirë edhe depistimin mjedisor) u përfshinë në rubrikën e kërkuar për alternativat në VNM, sikurse e kërkon PO 4.01 për një projekt të Kategorisë A. Ekipi Drejtues beson se dhënia e informacionit dhe konsultimit për VNM-në e Projektit, që erdhi më pas, solli përmirësime të ndjeshme në procedurat e mëparshme të Shqipërisë.</p> <p>Veprimi: Mësimet e nxjerra nga gjetjet e Panelit do të inkorporohen në udhëzimet për stafin mbi Politikën mbrojtëse.</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
4.	<p>Moskryerja e Analizës Sociale</p> <p>Në bazë të analizës që u ka bërë dokumenteve të Projektit, Paneli arrin në përfundimin se gjatë përgatitjes dhe Vlerësimeve Mjedisore të Projektit nuk është marrë në konsideratë një gamë e gjerë çështjesh sociale dhe rreziqesh të mundshme ekonomike ndaj popullsisë së zonës, që do të vinin nga projekti, përcaktimi i vendndodhjes dhe efektet. Kjo nuk është në përputhje me politikën e Bankës.</p> <p>Gjithashtu, nuk ka pasur një integrim midis studimeve biofizike dhe sociale dhe midis Vlerësimit Mjedisor dhe studimeve ekonomike dhe teknike. Në të gjitha këto aspekte, Ekipi drejtues nuk ka arritur të sigurojë që të zbatohet përmbajtja e PO 4.01 gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të TEC-it të Vlorës.</p>	140-147	<p>Koment: Sipas mendimit të Ekipit Drejtues, çështjet sociale nuk perceptoheshin si një tipar i fuqishëm i investimit, gjatë procesit të VM-së në vitin 2003, sepse TEC-i nuk ndodhej në një zonë të banuar por në një vendndodhje relativisht të izoluar, mbrapa një plazhi jo të zhvilluar, 6 kilometra larg Vlorës. Nuk dukej se kishte ndonjë dallim të madh mes grupeve të palëve të interesuara apo dallime etnike apo klasore lidhur me centralin. Ekzistonte një miratim i përgjithshëm se Shqipërisë i duhej ta zmadhonte kapacitetin e prodhimit të energjisë dhe t'i diversifikonte burimet energjetike. Në pamje të parë, nuk kishte asnjë grupim social i cili të kishte lidhje me çështjen e gjetjes së vendndodhjes së termocentralit. Të vetmit përdorues të konsiderueshëm të zonës ishin peshkatarët dhe vendasit që bëjnë plazh në afërsi të vendndodhjes së termocentralit.</p> <p>Megjithëse ka justifikime të mira ekonomike dhe teknike për vendndodhjen e centralit, nëse do të ishin bërë konsultime më të gjera, mund të ishin evidentuar dallimet brendapërbrenda opinionit publik lidhur me centralin dhe ndërtimin e tij në Gjirin e Vlorës dhe, mbase, mund të ishte evidentuar kundërshtimi lidhur me të. Nëse do të kishte konsultime më të gjera, atëherë do të ishin evidentuar vizionet dhe aspiratat e palëve të interesuara lokale për Vlorën, përfshirë edhe turizmin. Mirëpo, këto dolën në dritë vetëm në janar 2005, pas rreth tetë muajsh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Projektit dhe shumë kohë pas mbylljes së procesit të VM-së. Ekipi Drejtues e pranon se këto çështje që dolën pas VNM-së do të ishin administruar më mirë nëse Projekti do të kishte një zë për informim dhe punë afruese me publikun.</p> <p>Veprimet: Ekipi Drejtues do ta nxisë fuqimisht KESH-in për të rritur angazhimin me banorët e Vlorës. Në këto veprimtaritë mund të përfshihen: (i) krijimi i një këshilli konsultativ me qytetarët; (ii) marrja e një specialisti me kohë të plotë për punë afruese; (iii) hartimi i programeve të punës afruese, siç janë vizitat studentëve dhe nxënësve në termocentral. Pritet të dalë një projekt-plan angazhimi brenda datës 30 tetor 2009, ndërsa plani përfundimtar pritet të dalë brenda datës 30 dhjetor 2009.</p> <p>Ekipi Drejtues është i angazhuar për fuqizimin e vlerësimit të aspekteve sociale dhe kulturore të investimeve përmes zbatimit të politikës së VM-së si edhe të politikave sociale dhe operative të lidhura. Lidhur me të ardhmen, Ekipi Drejtues do të punojë të kujdeset që: (1) efektet e rëndësishme sociale të identifikohen në fillim të studimit të korrektësisë nga Banka; (ii) të administrohen efektet negative dhe të zhvillohen shanset sociale; dhe (iii) Banka t'i mbikëqyrë këto aspekte gjatë gjithë ciklit të Projektit. Për këtë qëllim, Ekipi Drejtues po sqaron ndarjen e punës dhe të përgjegjësiive të stafit teknik social dhe mjedisor, lidhur me vlerësimin e korrektësisë dhe mbikëqyrjen. Kjo pritet të përfundojë brenda muajit mars 2010.</p> <p>Lidhur me konsultimet dhe dhënien e informacioneve publike, do t'u ngarkohet specialistëve socialë detyra që të kujdesen që cilësia, objekti dhe shpeshësia e konsultimeve publike të jenë adekuate dhe të dokumentuara mirë. Lidhur me këtë, në dy muajt në vijim, do të fillojë trajnimi i rregullt i stafit të zhvillimit social.</p> <p>Ekipi Drejtues vëren gjithashtu se përmirësimi i vlerësimit të efekteve sociale të projekteve është njëra prej masave për Rajonin e EAQ-së, pas shqyrtimit që i bëri Bordi Raportit të Inspektimit për Projektin e MIZB-së në Shqipëri. Ekipi Drejtues do të kujdeset që fuqizimi institucional në këtë aspekt të bëhet</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
			edhe për projektet e mëdha të infrastrukturës dhe energjisë, për ta rritur edhe më shumë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre në kohë (kjo masë është në zbatim).
5.	<p>Laguna e Nartës dhe Politika e Bankës “Për habitatet natyrore”</p> <p>Paneli arrin në përfundimin se Ekipi Drejtues ka qenë i saktë në vendimin se TEC-i i Vlorës nuk e vë në lëvizje PO 4.04. Paneli konstaton se nuk ka asnjë arsye të pritë që TEC-i do të jetë i dëmshëm për habitatet natyrore.</p>	148-160	<p>Koment: Ekipi Drejtues vëren konstatimin e Panelit.</p> <p>Veprimi: Nuk nevojitet asnjë veprim.</p>
6.	<p>Efektet në Cilësinë e Ajrit</p> <p>Çlirimet atmosferike nga TEC-i i Vlorës janë llogaritur duke i mbajtur parasysh siç duhet Manualin e Bankës Botërore “Për ndotjen dhe parandalimin”. Të dhënat e futura në model për fazën e shfrytëzimit janë të duhura. Por, nuk mund të gjendet asnjë informacion provues se është bërë ndonjë përpjekje për të përdorur modelimin e përhapjes atmosferike për ta optimizuar lartësinë e oxhaqeve të TEC-it. Paneli konstaton se çlirimet atmosferike të TEC-it nuk përbëjnë ndonjë rrezik të ndjeshëm dëmtimi as për popullatën njerëzore të Vlorës e as për florën dhe faunën e Lagunës së Nartës.</p>	161-169	<p>Koment: Ekipi Drejtues vëren konstatimin e Panelit për mungesën e pritit të rreziqeve të ndjeshme ndaj shëndetit të banorëve dhe komunitetit apo ndaj florës dhe faunës në zonën e mbrojtur të Lagunës së Nartës. Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë se natyra e kontratës së PPN-së kërkon që performanca të vendoset në fazën e paraqitjes së ofertave ndërsa hollësitë e projektit (siç është lartësia e oxhaqeve) të përcaktohet më pas.</p> <p>Veprimi: Ekipi Drejtues do të raportojë për progresin që ka arritur KESH-i lidhur me monitorimin në rregullsi të parametrave mjedisore që lidhen me operacionet e Projektit, së bashku me bërjen publike të informacioneve përkatëse të monitorimit.</p>
7.	<p>Efektet te Mjedisi Detar</p> <p>VNM hesht lidhur me shkallën e efekteve të mundshme në mjedisin detar gjatë fazës së ndërtimit. VNM ia vendos përgjegjësinë palës së kontraktuar për PPN-në për të siguruar një efekt minimal mjedisor dhe social. Megjithatë, VNM-ja nuk rekomandon asnjë mekanizëm për të siguruar që pala e kontraktuar për PPN-në i ka përmbyshur apo jo detyrimet. Nuk ka asnjë kërkesë për miratimin e metodave dhe nuk është specifikuar asnjë standard që duhet përmbyshur. Në këtë aspekt, VNM-ja është i mangët.</p> <p>Gjithashtu, Paneli konstaton se mosveprimi për të marrë në konsideratë, si në VNM-në Përfundimtare ashtu edhe në Shtojcë, rreziqet afatmesme dhe afatgjata që lidhen me fazën e ndërtimit dhe mënyrat alternative të furnizimit të TEC-it të Vlorës me lëndë djegëse gjatë fazës së shfrytëzimit përbën një mangësi serioze dhe bën që VNM-ja Përfundimtar të mos jetë në zbatim të kërkesës së PO 4.01, e cila thotë: “Vlerësimi Mjedisor vlerëson rreziqet dhe efektet e mundshme mjedisore të një projekti në zonën e ndikimit të tij,” ku “zona e ndikimit” përkufizohet si “zona që ka të ngjarë të</p>	170-180	<p>Koment: Ekipi Drejtues pajtohet me Panelin e Inspektimit lidhur me nevojën për t’u siguruar që TEC-i të ketë procedurat e duhura për parandalimin e “efektit mjedisor mundësisht të rëndë nga rrjedhjet e mundshme të naftës gjatë furnizimit me lëndë djegëse.” Lidhur me mendimin e Panelit se “... nuk janë minimizuar rreziqet afatmesme dhe afatgjata që i kanosen mjedisit detar dhe plazheve të Gjirit të Vlorës nga rrjedhjet e mundshme gjatë shkarkimit të lëndës djegëse dhe se nuk ka plane për minimizimin e këtyre rreziqeve përpara fillimit të shfrytëzimit...” Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë se rreziqet e rrjedhjeve të naftës ishin të identifikuar mirë gjatë përgatitjes së Projektit. Janë përmendur shprehimisht rreziqet e rrjedhjeve të naftës, si gjatë ndërtimit ashtu edhe gjatë shfrytëzimit, në VNM-në e Projektit, ndërsa në PAM u futën masa për administrimin dhe zbutjen e këtyre rreziqeve. Nga ana e tij, PAM ishte pjesë e dokumenteve të tenderit për kontratën e PPN-së (Aneksi 5) për të ndërtuar TEC-in e Vlorës. Kjo është një praktikë e zakonshme, për të siguruar që pala e kontraktuar të realizojë punimet dhe projektet teknike në përputhje me PAM-në. PAM kërkon shprehimisht që pala e kontraktuar për PPN-në të përgatisë: (i) një Plan për Parandalimin e Derdhjeve të Naftës (për të minimizuar rreziqet e rrjedhjes së naftës); dhe (ii) një Plan Kundërpërgjigje ndaj Rrjedhjeve të Naftës (për të pastruar derdhjet e naftës nëse do të ndodhin, përkundër masave parandaluese). Krahas kësaj, në dokumentet ligjore të Projektit përfshihet një dispozitë specifike, e cila i kërkon KESH-it të kujdeset për vënien në zbatim të PAM-së: “KESH do të marrë ose do të kujdeset që të merren të gjitha masat e nevojshme për realizimin e PAM-së në kohën e duhur...”</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
	<p>preket nga projekti, përfshirë edhe të gjithë aspektet ndihmëse të tij, siç janë korridoret e transmetimit të energjisë, tubacionet...”</p> <p>Paneli ka shqetësimin se, për shkak të kësaj mangësie në VNM-në Përfundimtare dhe Shtojcën e tij, si edhe në Dokumentin e Vlerësimit të Projektit, nuk janë minimizuar rreziqet afatmesme dhe afatgjata që i kanosen mjedisit detar dhe plazheve të Gjirit të Vlorës nga rrjedhjet e mundshme gjatë shkarkimit në tokë të lëndës djegëse dhe se nuk ka plane për minimizimin e këtyre rreziqeve përpara fillimit të shfrytëzimit. Dokumentet e projektit, të cilat ka këqyru Paneli, nuk i kërkojnë huamarrësit të përfshijë masa kundër rreziqeve dhe të monitorojë efektivitetin e tyre.</p>		<p>Qeveria e Shqipërisë dhe Banka e kanë pranuar se KESH-i nuk i ka njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kontrollin mbikëqyrës të aspekteve mjedisore të ndryshme të Projektit të TEC-it të Vlorës. Për këtë qëllim, është financuar, në kuadër të komponentit të asistencës teknike të Projektit të Prodhimit dhe Ristrukturimit të Sektorit të Energjisë, edhe një konsulencë tjetër më vete, e cila përqendrohet vetëm te çështjet mjedisore. Pranë KESH-it është krijuar një Njësi e Administrimit Mjedisor (NJAM), për të ndjekur aspektet mjedisore të Projektit, dhe, qysh prej vitit 2006, kësaj njësie i është dhënë konsulencë specifike. Është marrë me nënkontratë edhe një firmë e njohur në botë, me njohuri teknike specifike për rrjedhjet e naftës. Një detyrë kyçe e firmës ishte: “Shqyrtimi i një plani për parandalimin dhe kundërpërgjigjen ndaj rrjedhjeve të naftës që përgatitet nga pala e kontraktuar për PPN-në.”</p> <p>Në bazë të përparimit të punimeve, duke filluar në tetor 2008, ekipi i Projektit i Bankës, së bashku me bashkëfinancuesit, i kërkuan KESH-it të jepte planet e parandalimit dhe kundërpërgjigjes së rrjedhjeve të naftës. Kështu, KESH-i kërkoi palës së kontraktuar për PPN-në të fillonte përgatitjen e planeve të parandalimit dhe kundërpërgjigjes për rrjedhjet e naftës. Pala e kontraktuar për PPN-në e paraqiti planin e parandalimit të rrjedhjeve të naftës në maj 2009. Konsulenti Mjedisor e shqyrtoi këtë plan dhe dha komentet e veta. Ekipi Drejtues beson se projektimi dhe ndërtimi i objekteve të lëndës djegëse në det janë të standardeve ndërkombëtare dhe se janë minimizuar rreziqet e rrjedhjes së naftës gjatë shkarkimit të lëndës djegëse. Ekipi Drejtues vëren se pritet që TEC-i i Vlorës të marrë 15 deri 20 furnizime me depozita të vogla në vit (duke supozuar një shfrytëzim me ngarkesë bazë rreth 80 %).</p> <p>Deri më 3 shtator 2009, Planet e Parandalimit dhe Kundërpërgjigjes ndaj Rrjedhjeve të Naftës për objektet bregdetare të TEC-it të Vlorës, përfshirë edhe pajisjet dhe strukturat e kufizimit të dëmit, vazhdonin të ishin në zbatim. Lidhur me objektet në det, ekziston Plani i Parandalimit të Rrjedhjeve të Naftës, ndërkohë që është duke u finalizuar Plani i Kundërpërgjigjes ndaj Rrjedhjeve të Naftës dhe duhet të jetë në zbatim përpara se të fillojë shfrytëzimi i TEC-it.</p> <p>Çështjet mjedisore të lidhura me linjat e transmetimit të energjisë elektrike trajtohen në VNM-në e Projektit.</p> <p>Veprimi: Duke qenë se nuk është ende tërësisht i gatshëm Plani i Kundërpërgjigjes ndaj Rrjedhjeve të Naftës në det, Banka do të mbikëqyrë përfundimin e këtij plani përpara futjes në shfrytëzim rutinë të objektit (çka mendohet, hë për hë, se do të ndodhë në fillim të muajit nëntor 2009), siç e kërkon edhe Kontrata e Kredisë.</p>
8.	<p>Efektet Progressive</p> <p>Paneli konstaton se stafi i Bankës duhet të kishte ngulur këmbë për një VM sektorial dhe për analizën e pasojave progresive të lidhura, krahas vlerësimit mjedisor specifik të projektit.</p> <p>Paneli vëren se mosanalizimi i efektit progresiv të zgjerimit të mundshëm të TEC-it të Vlorës në VNM-në Përfundimtare nuk është në përputhje me Udhëzimet e vetë Bankës për</p>	181-194	<p>Koment: Ekipi Drejtues e pranon se VNM-ja e Projektit duhet të kishte qenë më e qartë lidhur me mbulimin e efekteve të mundshme progresive të dy njësive prodhuese, krahas asaj që bashkëfinancohet nga Banka (të cilat do ta zgjeronin TEC-in e Vlorës deri në kapacitetin 300 MW, që mund të mbajë objekti). Ekipi Drejtues sqaron se, ndërkohë që studimet e realizueshmërisë dhe të vendndodhjes të realizuar nga Qeveria e Shqipërisë e shqyrtonin si mundësinë me kapacitet 100 MW, ashtu edhe atë me kapacitet 300 MW, Banka dhe bashkëfinancuesit e saj mendonin se mundësia financiare e njësive shtesë në periudhën afatshkurtër deri afatmesme ishte</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
	termocentralet e reja.		<p>shumë e ulët. Ekipi Drejtues vëren se ky qëndrim vlen ende edhe sot, pas tetë vjetësh.</p> <p>Përkundër fokusit të deklaruar vetëm të një njësi, gjatë VNM-së u bënë llogaritjet fillestare të çlirimeve në ajër dhe ujë nga një objekt me kapacitet 300 MW. Megjithatë, Ekipi Drejtues e pranon se paraqitja e të dhënave mbi efektin progresiv në ajër dhe ujë nuk ishin nënvizuar qartë në VNM-në përfundimtare të Projektit, çka ka shkaktuar konfuzion. Ekipi Drejtues vëren se konsulentët mjedisorë të KESH-it kanë dhënë llogaritje të përditësuara të çlirimeve atmosferike nga një objekt me kapacitet 300 MW, mbështetur në matjet e cilësisë së ajrit, që janë bërë përpara fillimit të punimeve ndërtimore. Këto llogaritje bëjnë të ditur se, për një objekt me kapacitet 300 MW, të gjithë parametrat kyç (grimcat në ajër, dioksidi i azotit dhe dioksidi i squfurit) do të ishin brenda kufijve të lejueshëm krahasuar me udhëzuesit e zbatueshëm të BE-së apo Bankës Botërore. Efektet termike në Gjirin e Vlorës nga shkarkimi i ujit ftohës prej një objekti me kapacitet 300 MW parashikohen të jenë brenda kufijve të lejueshëm, sikurse vëren edhe Paneli.</p> <p>Ekipi Drejtues beson se, për të qenë konform PO 4.01, nuk kërkohet një VNM objekti i së cilës shkon përtej TEC-it dhe investimeve shoqëruese (furnizimi me lëndë djegëse, tubacionet për ujin ftohës dhe linja e transmetimit), ku të përfshiheshin edhe vendndodhjet alternative dhe/ose investimet industriale apo energjetike të afërta (faktike apo të propozuara), apo objektet e tjera energjetike në zonën e Vlorës. Shpjegimi për këtë jepet në rubrikën “Çështjet kyçe”, ku, ndër të tjera, jepet mungesa e lidhjeve financiare apo ekonomike dhe natyra jo e konfirmuar e këtyre investimeve.</p> <p>Veprimi: Mësimet e nxjerra nga gjetjet e Panelit do të inkorporohen në udhëzimet për stafin mbi Politikat mbrojtëse.</p>
ZBATIMI I KËRKESAVE SOCIALE DHE KULTURORE			
9.	<p>Vlerësimi dhe Administrimi i Pasurisë Kulturore: Vlerësimi i Projektit</p> <p>Paneli konstaton se nga fazat e hershme të realizueshmërisë dhe deri në vlerësimin e Projektit, Banka nuk kërkoi të marrë informacion për praninë dhe rolin e pasurive kulturore në zonën e Vlorës. Banka nuk u kujdes që këto studime të shqyrtojnë rreziqet e mundshme dhe efektet negative të vendosjes së një termocentrali industrial në një zonë që mbështetet në turizmin kulturor dhe detar. Koncepti dhe strukturimi i Projektit i ka shpërfillur këto rreziqe.</p> <p>Mbështetur në këto konstatime, Paneli arrin në përfundimin se përgatitja e Projektit, përfshirë proceset e realizueshmërisë dhe të VNM-së dhe vlerësimin e Projektit, nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e DMP 2.20 për vlerësimin e projekteve, për analizën e rreziqeve dhe me kërkesat procedurale të Politikës së Bankës “Për administrimin e pasurive kulturore në projektet e financuar</p>	195-226	<p>Koment: Ekipi Drejtues e pranon se nuk është realizuar një vërtetim për burimet kulturore gjatë përgatitjes së Projektit dhe se ka deklaruar gabimisht se nuk ekzistonte asnjë burim lidhur me trashëgiminë kulturore të zonës. Praktika e Bankës ishte ta vinte në lëvizje NPO 11.03 vetëm kur kishte arsye për të dyshuar se Projekti mund të trazonte mbetje arkeologjike apo monumente të tjera kulturore të rëndësishme. Sikurse vërehet nga Paneli, një mision mbikëqyrjeje në vitin 2006, në të cilin bënte pjesë një arkeolog profesionist, konstatoi se nuk kishte të ngjarë që atje të gjendej asnjë mbetje arkeologjike dhe kjo është vërtetuar në praktikë nga gërmimet për ndërtimin e centralit.</p> <p>Veprimi: Mësimet e nxjerra nga gjetjet e Panelit do të inkorporohen në udhëzimet për stafin mbi Politikat mbrojtëse.</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
	nga Banka” (NPO 11.03). Sipas mendimit të Panelit, në përputhje me NPO 11.03, duhet të ishte realizuar nga një specialist një vrojtim zbulues në terren. Paneli konstaton se kjo nuk është bërë.		
10.	<p>Vlerësimi dhe Administrimi i Pasurisë Kulturore: Pas Vlerësimit të Projektit</p> <p>Nga shqyrtimi që u ka bërë dokumenteve të Projektit, Paneli vëren se Ekipi Drejtues e ka ngushtuar analizën e tij duke u përqendruar vetëm te efekti i Projektit mbi një truall të vogël (6 hektarë), të zënë nga vetë TEC-i, dhe duke mos analizuar rrjedhojat e mundshme të vendosjes së TEC-it, për zonën e gjerë të Vlorës.</p> <p>Edhe pse Paneli e pranon se ky mision [mbikëqyrje në korrik 2006] ishte dërguar në formë pranimit të mungesës së një vrojtimi zbulues në një fazë të mëparshme, Paneli vëren se një mision i tillë retrospektiv (i kryer pas miratimit të vendndodhjes nga Qeveria dhe nga Banka) nuk u jep mundësi argumenteve të lidhura me pasurinë kulturore të kenë një ndikim në vendimin për vendndodhjen e TEC-it dhe për efektet e mundshme afatgjata të tij. Konstatimi pozitiv se gjatë gërmimeve për themelin e TEC-it nuk ka pasur asnjë gjetje të rastësishme arkeologjike e largon shqetësimin se vetë trualli i TEC-it mund të mbulojë përgjithmonë relikte të rëndësishme arkeologjike, mirëpo, ky konstatim nuk i eliminon rreziqet dhe ndikimet afatgjata që sjell prania dhe shfrytëzimi i TEC-it në Gjirin e Vlorës dhe për potencialin e tij për zhvillim të turizmit, si edhe për të ardhurat dhe mjetet e jetesës së popullatës lokale. Mbeten ende të trajtohen dhe të zbuten këto rreziqe dhe efekte.</p>	247-255	<p>Koment: Ekipi Drejtues i pranon konstatimet e Panelit dhe rithekson se deri në shtator 2009, kur në kantier kishte mbaruar pjesa më e madhe e gërmimeve dhe punëve ndërtimore, nuk ishte bërë asnjë gjetje e rastësishme me natyrë arkeologjike apo kulturore në kantier, çka konfirmon parashikimin e misionit të muajit korrik 2006.</p> <p>Sa u përket pikave arkeologjike të Kepit të Terportit/Aulonës, Orikumit, Kështjellës së Kaninës dhe Kishës së Marmiroit, të gjitha këto ndodhen në një distancë të caktuar nga termocentrali, i cili, nga shumica e këtyre pikave, nuk duket. Në asnjërin prej këtyre pikave nuk do të kalojnë rrugë, naftësjellës apo linja transmetimi. Kërkesit apo Paneli nuk kanë cituar asnjë informacion provues se turistët nuk do të shkojnë në këto pika me vlera historike për shkak të afërsisë së tyre me vendndodhjen e TEC-it. Ekipi Drejtues beson se më shumë se ekzistenca e një centrali elektrik në rrethina, në numrin e vizitave të turistëve ndikojnë faktorë të tillë si lidhja me rrugë, përmirësimi i vendit dhe ekzistenca e shërbimeve të tilla si udhërrëfyesit, muzetë apo librat informues.</p> <p>Veprimi: Banka do të vijojë mbikëqyrjen e Projektit për çdo gjetje të rastësishme të pasurive kulturore gjatë gjithë kohës, deri në mbyllje të Projektit.</p>
11.	<p>Mungesa e Vlerësimit Social dhe Mungesa e Analizës së Rreziqeve Sociale</p> <p>Paneli konstaton se nuk janë marrë aspak në konsideratë një gamë e gjerë e çështjeve sociale gjatë përgatitjes dhe vlerësimit, dhe se analizat përkatëse sociale dhe ekonomike nuk janë integruar në brumin e Projektit. Ekipi Drejtues nuk ka bërë analizën e nevojshme sociologjike dhe analizën e rreziqeve lidhur me efektet e mundshme afatgjata të Projektit dhe, kështu, nuk ka siguruar zbatimin e DMP 2.20 “Për vlerësimin e projekteve”.</p>	227-238	<p>Koment: Shih pikën 4, më lart.</p> <p>Veprimet: Ekipi Drejtues do ta nxisë fuqimisht KESH-in për të rritur angazhimin me banorët e Vlorës. Në këto veprimtaritë mund të përfshihen: (i) krijimi i një këshilli konsultativ me qytetarët; (ii) marrja e një specialisti me kohë të plotë për punën afruese; (iii) hartimi i programeve të punës afruese, siç janë vizitat studentëve dhe nxënësve në termocentral. Pritet të dalë një projekt-plan angazhimi brenda datës 30 tetor 2009, ndërsa plani përfundimtar pritet të dalë brenda datës 30 dhjetor 2009.</p> <p>Ekipi Drejtues është i angazhuar për fuqizimin e vlerësimit të aspekteve sociale dhe kulturore të investimeve përmes zbatimit të politikës së VM-së si edhe të politikave sociale dhe operative të lidhura. Lidhur me të ardhmen, Ekipi Drejtues do të punojë të kujdeset që: (1) efektet e rëndësishme sociale të identifikohen në fillim të studimit të korrektësisë nga Banka; (ii) të administrohen</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
	<p>Paneli konstaton se këto shkelje të politikave kanë ndikuar drejtpërdrejt në vendimin për vendndodhjen e TEC-it të Vlorës.</p> <p>Ato e kanë penguar Ekipin Drejtues të kuptojë se çfarë mund të sjellë prania e termocentralit dhe strukturave ndihmëse të tij lidhur me uljen e fluksit të turistëve kulturorë dhe detarë në zonat e Gjirit të Vlorës, uljen e veprimtarive ekonomike dhe të të ardhurave të zonës dhe potencialin e saj për zhvillim të mëtejshëm.</p> <p>Paneli arrin edhe në përfundimin se Ekipi Drejtues nuk ka vepruar konform kërkesave të Bankës për realizimin e një analize të rreziqeve dhe për përfshirjen e metodave dhe masave parandaluese për të parandaluar dhe zvogëluar rreziqet. Mungesa e një "analize formale të rreziqeve", sikurse parashikohet shprehimisht në DMP 2.20 dhe, veçanërisht, të rreziqeve sociale dhe ekonomike afatmesme dhe afatgjata për popullatat lokale, ka lënë një boshllëk të rëndësishëm në strukturimin e Projektit dhe e ka lënë popullatën lokale të pambrojtur nga rreziqet afatgjata që u kanosen veprimtarive tregtare dhe të ardhurave të saj.</p>		<p>efektet negative dhe të zhvillohen shanset sociale; dhe (iii) Banka t'i mbikëqyrë këto aspekte gjatë gjithë ciklit të Projektit. Për këtë qëllim, Ekipi Drejtues po sqaron ndarjen e punës dhe të përgjegjësiive të stafit teknik social dhe mjedisor, lidhur me vlerësimin e korrektësisë dhe mbikëqyrjen. Kjo pritet të përfundojë brenda muajit mars 2010.</p> <p>Lidhur me konsultimet dhe dhënien e informacioneve publike, do t'u ngarkohet specialistëve socialë detyra që të kujdesen që cilësia, objekti dhe shpeshësia e konsultimeve publike të jenë adekuate dhe të dokumentuara mirë. Lidhur me këtë, në dy muajt në vijim, do të fillojë trajnimi i rregullt i stafit të zhvillimit social.</p> <p>Ekipi Drejtues vëren gjithashtu se përmirësimi i vlerësimit të efekteve sociale të projekteve është njëra prej masave për Rajonin e EAQ-së, pas shqyrtimit që i bëri Bordi Raportit të Inspektimit për Projektin e MIZB-së në Shqipëri. Ekipi Drejtues do të kujdeset që fuqizimi institucional në këtë aspekt të bëhet edhe për projektet e mëdha të infrastrukturës dhe energjisë, për ta rritur edhe më shumë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre në kohë (kjo masë është në zbatim).</p>
12.	<p>Mosbërja e analizës për kontributet e turizmit</p> <p>Ekipi Drejtues thotë se "lidhur me efektet mbi potencialin e turizmit, kjo nuk është një çështje që mbulohet drejtpërdrejt nga politikat mbrojtëse të Bankës..." Kjo nuk përbën arsye për të mospërfshirë efektet te jeta e vërtetë, duke qenë se projektet e Bankës u nënshtrohen jo vetëm politikave mbrojtëse, por të gjitha politikave operative. Rreziqet e efektit social dhe rreziqet ekonomike mbulohen në politika të tilla si DMP 2.20 dhe PO/PB 10.04, të cilat janë të dyja të zbatueshme në rastin e Projektit.</p> <p>Logjika mbështetëse e Bankës për Projektin nuk e vendoste Projektin në kontekstin rrethues social, ekonomik dhe demografik dhe këto rreziqe i ka lënë jashtë objektit të vet.</p>	239-246	<p>Koment: Ekipi Drejtues pajtohet me konstatimet e Panelit:¹ "Vetë trualli i TEC-it nuk është një zonë natyrore e virgjër me ndonjë potencial të madh për të tërhequr turistë. [Ishulli i Zvërnësit dhe Kepi i Treporit, si edhe pjesa më e madhe e vijës bregdetare të Gjirit të Vlorës] asnjëra prej këtyre nuk do të preken nga TEC-i ..." Megjithatë, Paneli konstaton se mund të mbetet në rrezik "ndjesia e vendit" e Kepit të Treporit dhe Gjirit të Vlorës si pikë turistike e dëshirueshme, për shkak të shfrytëzimit të TEC-it dhe zhvillimeve të tjera të propozuara.²</p> <p>Ekipi Drejtues e pranon se mund të ketë disa efekte, të lokalizuara dhe të ngushta në zonën e Projektit, lidhur me turizmin. Ngaqë termocentralet kanë nevojë të jenë pranë rrugëve ujore për transportimin e sasive të mëdha të lëndës djegëse dhe për të përdorur sasi të konsiderueshme uji për ftohje, nuk ndodh rrallë që centrale të tilla të ndërtohen pranë detit. Një numër i konsiderueshëm ishujsh në Mesdhe kanë ndërtuar termocentrale në brigjet e tyre, dhe, përsëri, turizmi ka ecur përpara me vrull si pasojë, ndër të tjera, edhe e një furnizimi të sigurt me energji elektrike.</p> <p>Ekipi Drejtues e pranon se nuk janë marrë në konsideratë në analizën ekonomike të Projektit disa kosto eksternale të lidhura me turizmin. Megjithatë, kosto të tilla nuk do ta kishin ndryshuar ndjeshëm vlerësimin ekonomik të Projektit, sepse ka shumë të ngjarë që ato të kompensoheshin nga përfitimet që do t'i vinin</p>

¹ Raport i investigimit, para. 107.

² Po aty.

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
			<p>turizmit nga furnizimi i sigurt me energji. Krahas kësaj, Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë se, shprehur në terma vjetorë, do të duhej që këto kosto ta kalonin vlerën 1,8 milion dollarë amerikanë për vendndodhjen në Fier, në mënyrë që të zgjidhej ajo dhe jo Vlora B. Duke pasur parasysh faktin se trualli i TEC-it është i vogël dhe se nuk ka efekte të drejtpërdrejta në Gjirin e Vlorës, sikurse e pranon edhe Paneli, nuk ka të ngjarë që humbjet e mundshme në të ardhurat nga turizmi të ishin aq të larta saqë të justifikonin kostot shtesë të ndërtimit të centralit në Fier.</p> <p>Ekipi Drejtues pranon edhe se, nëse bëhen ndërtime të tjera industriale në zonë, mund të preket turizmi në zonën e Treportit. Por, kjo është një çështje e cila trajtohet përmes ligjit të ri shqiptar për planifikimin e territorit.</p> <p>Veprimi: Mësimet e nxjerra nga gjetjet e Panelit do t'i përcillen stafit.</p>

VLERËSIMI EKONOMIK

13.	<p>Analiza Ekonomike e Alternativave</p> <p>Paneli konstaton se si pasojë e gabimeve në përfshirjen e matjeve të koston në niveluar dhe mosmarrjes siç duhet në konsideratë të efekteve sociale dhe mjedisore në matricën e vendimmarrjes, Ekipi Drejtues nuk arriti të zbatojë kërkesat e PO 10.04 dhe DMP 2.20 sa i takon përgatitjes së një vlerësimi ekonomik i cili të identifikojë dhe llogarisë ë gjitha kostot, përfshirë edhe kostot oportune, që lidhen me Projektin.</p>	257-283	<p>Koment: Ekipi Drejtues pajtohet me konstatimet e Panelit: “(i) çlirimit atmosferike nuk përbëjnë ndonjë rrezik të ndjeshëm dëmtimi as për popullatën njerëzore të Vlorës e as për florën dhe faunën e Lagunës së Nartës;³ dhe (ii) mjedisi detar nuk do të preket ndjeshëm nga vënia në punë e sistemit ftohës së centralit⁴ Pra, duket se i vetmi dëm i mundshëm ndaj peshkimit mund të ishte një rrjedhje e mundshme e një shkalle aq të madhe sa ta dëmtonte në mënyrë të pariparueshme peshkimin në Gjirin e Vlorës. Analistët e Panelit vlerësojnë se dëmi ndaj peshkimit mund të jetë me një vlerë vjetore prej 843.000 dollarë amerikanë.⁵ Ekipi Drejtues dëshiron të theksojë se kjo vlerë dëmi do të kërkonte ndodhjen e rastit më të keq (për shembull, përplasjen e dy depozitave me njëra tjetrën), dhe jo ndonjë gjë të lidhur me shkarkimin e zakonshëm të lëndës djegëse për TEC-in në vend-ankorim. Gjithashtu, që të lindin kosto të tilla vjetore, do të duhej të supozohej rasti më i keq (domethënë, po të mos pastrohej për shumë vjet nafta e derdhur).</p> <p>Lidhur me krahasimin e dy vendndodhjeve Vlora B dhe Fier, nëse duam t'i marrim në konsideratë eksternalitete të tilla, Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë se rreziqet e rrjedhjes së naftës vlejné njësoj si për vendndodhjen në Fier ashtu edhe për vendndodhjen Vlora B, duke qenë se të dy vendndodhjet do të përdornin objekte të ngjashme për lëndën djegëse. Pra, nuk do të kishte ndryshuar vlerësimi i përzgjedhjes së vendndodhjes.</p> <p>Duke pasur parasysh strukturimin e Projektit: (i) për të minimizuar rreziqet e rrjedhjes së naftës (Plan për Parandalimin e Derdhjeve të Naftës); dhe (ii) për të zbutur çdo rrezik tjetër të mbetur (Plan Kundërpërgjigje ndaj Rrjedhjeve të Naftës), Ekipi Drejtues beson se analiza ekonomike e Projektit, në mënyrë të saktë, u jep pak vlerë kostove të eksternalitetit lidhur me dëmin ndaj peshkimit.</p> <p>Ekipi Drejtues vëren se raporti i Panelit lidhur me analizën ekonomike që çoi në përzgjedhjen e vendndodhjes Vlora B bën një analizë ex-post të alternativës së ndërtimit të të njëjtit TEC në Fier (vendndodhja e cila doli e dyta në renditjen e bërë në</p>
-----	--	---------	--

³ Raport i investigimit, para. 169, faqe 40.

⁴ Raport i investigimit, para. 174, 175.

⁵ Raport i investigimit, para. 296.

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
			<p>studimin për vendndodhjen nga konsulentit), mirëpo nuk arrin në ndonjë përfundim nëse duhej të ishte zgjedhur kjo vendndodhje në bazë të analizës ekonomike të kostove dhe përfitimeve. Ekipi Drejtues dëshiron të sqarojë disa çështje të caktuara lidhur me analizën e Panelit për Fierin, e cila ka prirjen të bëjë të ditur se edhe sot, kur kemi mundësinë t'i hedhim sytë mbrapa dhe kur kemi fituar njohuri të tjera shtesë krahasuar me kohën kur është vlerësuar Projekti, mbi bazën analizës ekonomike vendndodhja në Vlorë përsëri mund të dilte si më e preferuara. Paneli bën disa rregullime të caktuara për të rivlerësuar llogaritjet e kostove të niveluara, të paraqitura në studimin për vendndodhjen, duke krahasuar vendndodhjet Fier dhe Vlorë B. Në lidhje me këtë, Ekipi Drejtues dëshiron të theksojë si më poshtë. Së pari, objekti për shkarkimin e lëndës djegëse, i ndërtuar për Vlorë B, do të kishte qenë i nevojshëm edhe për centralin në Fier. Fieri nuk ndodhet në bregdet, kështu që do të ekzistonte nevoja për të transportuar sasinë e mjaftueshme të lëndës djegëse deri në central, çka do të kërkonte një naftësjellës të gjatë, i cili do të shoqërohej nga potenciali për efekte mjedisore gjatë ndërtimit. Duke pasur parasysh afërsinë e Fierit me Gjirin e Vlorës dhe mungesën e porteve të afërt alternativë, ka shumë të ngjarë që edhe për Fierin të ishin të nevojshme objekte të lëndës djegëse të ngjashme me ato ekzistueset. Rrjedhimisht, rregullimi i kostos kapitale për Vlorë B vlen edhe për alternativën në Fier. Së dyti, kur, në vitin 2007, KESH-i iu drejtua palës së kontraktuar për PPN-në për të negociuar një zbritje në çmim për largimin e mundshëm të objekteve të lëndës djegëse në det në kuadër të Projektit (duke menduar alternativën e Petroliferës), pala e kontraktuar për PPN-në bëri të ditur se vlera gjithsej e kontratës do të zvogëlohej vetëm me 3 milion dollarë amerikanë (dhe jo 6 milion dollarë amerikanë, sikurse thuhet në faqen 66 të raportit të Panelit). Sa më lart, rregullimet e bëra në raportin e Panelit çojnë në një mbivlerësim të kostove të Vlorë B. Megjithatë, edhe pas këtyre rregullimeve, duket qartë se vendndodhja Vlorë B është zgjedhja më e mirë në bazë të kostove të "internalizuara".</p> <p>Veprimi: Mësimet e nxjerra nga gjetjet e Panelit do t'i përcillen stafit.</p>
14.	<p>Vendndodhja në Fier Duke pasur parasysh rekomandimin e Studimit të Sektorit Energjetik për të mos rehabilituar objektet e vjetra në Fier, vendimi në analizën e TEC-it për të mos analizuar rehabilitimin e centralit të Fierit, si një alternativë ndaj projektit të propozuar, konsiderohet se është në përputhje me paragrafin 12 të DMP 2.20.</p>	284-286; 287-293	<p>Koment: Ekipi Drejtues vëren konstatimin e Panelit për zbatimin e kërkesave. Veprimi: Nuk nevojitet asnjë veprim.</p>
15.	<p>Vlerësimi i Eksternaliteteve Mbështetur në investigimin e Panelit, duket qartë se ka pasur informacion të arsyeshëm për Ekipin Drejtues që ky i fundit të shqetësohej në lidhje me rreziqet dhe pasojat negative afatgjata të një TEC-i në vendndodhjen Vlorë B, lidhur me sektorët e peshkimit dhe turizmit të Vlorës. Paneli konstaton se analiza ekonomike e Ekipit Drejtues nuk ka marrë në konsideratë eksternalitetet e</p>	294-306	<p>Koment: Shih pikat 12 dhe 13, më lart, si edhe rubrikën "Çështjet Kyçe" për vlerësimin ekonomik të alternativave. Veprimi: Mësimet e nxjerra nga gjetjet e Panelit do t'i përcillen stafit.</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
	rëndësishme që mund të kenë një efekt me rëndësi materiale në analizën e kostos së niveluar. Rrjedhimisht, Paneli arrin në përfundimin se vlerësimi ekonomik nga Ekipi Drejtues nuk është në përputhje me PO 10.04, e cila thotë: <i>“vlerësimi ekonomik i projekteve të financuara nga Banka merr në konsideratë çdo eksternalitet brenda vendit dhe jashtë tij.”</i>		
KONSULTIMET, PJESËMARRJA DHE DHËNIA E INFORMACIONIT			
16.	<p>Strukturimi dhe Drejtimi i Konsultimeve Publike</p> <p>Paneli arrin në përfundimin se përmes një procesi të mangët të vlerësimit mjedisor, Ekipi Drejtues nuk ka arritur të sigurojë konsultime publike të kuptimta për Projektin, çka nuk është në zbatim të PO 4.01.</p> <p>Mbështetur në shqyrtimin e grafikut kohor të Projektit dhe në analizën e dokumenteve të Projektit, dhe duke marrë në konsideratë se palët e prekura patën vetëm një përfshirje minimale në vendimet jetike lidhur me Projektin, Paneli nuk pajtohet me mendimin e Ekipit Drejtues se sipas Politikës së Bankës ky angazhim minimal i palëve të prekura pasi janë marrë vendimet kritike në lidhje me Projektin përbën <i>“konsultim dhe dhënie informacioni ... gjatë përgatitjes së projektit në një mënyrë që të jetë e kënaqshme për Bankën...”</i></p> <p>Paneli arrin në përfundimin se Ekipi Drejtues nuk u ka dhënë njoftim të mjaftueshëm personave të prekur nga Projekti dhe OJQ-ve lokale dhe nuk e ka siguruar pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e konsultimeve, sikurse kërkohet nga PO 4.01.</p>	333-352	<p>Koment: Qeveria zhvilloi tri konsultime publike për TEC-in. Konsultimi i parë, në fund të muajit tetor 2002, u përqendrua te rezultatet e studimit për vendndodhjen dhe i parapriu vendimit të Bankës për të filluar me përgatitjen zyrtare të Projektit. Sipas artikujve të gazetave, në këtë konsultim u përfshinë zyrtarë lokalë dhe rajonalë, akademikë, OJQ, intelektualë dhe persona të tjerë. Gjatë diskutimit, u ngritën çështje të lidhura me teknologjinë, efektet lokale dhe vendndodhjet alternative.</p> <p>VNM-ja e Projektit e përmbushi kërkesën për dy faza konsultimi, e cila parashikohet në PO 4.01: në fazën e hershme (termat e referencës për VNM-në) dhe, më pas, në fazën e projekt-raportit të VNM-së. Këto konsultime janë zhvilluar, përkatësisht, më 2 prill 2003 dhe 3 shtator 2003. Sikurse vërehet edhe në grafikun kohor në Raportin e Investigimit, VM-ja iu vendos për herë të parë në dispozicion publikut më 23 korrik 2003 (Draft), çka u ndoq nga publikimi i VNM-së në tetor dhe i Shtjocës së VNM-së në janar 2004. Mbyllja e periudhës së bërjes publike të informacionit, për BERZH-in, për të njëjtat dokumente të VNM-së së Projektit ishte data 7 qershor 2004.</p> <p>Ekipi Drejtues pranon mangësi të mundshme lidhur me angazhimin e kuptimtë me publikun, gjatë procesit të përzgjedhjes së vendndodhjes, të cilat penguan: (i) një njohje të mirë me këndvështrimet e shoqërisë lidhur me vendndodhjet alternative dhe me kriteret për vendndodhjen; (ii) marrjen e mendimeve nga banorët e zonës së Vlorës lidhur me vendndodhjen e preferuar në komunitetin e tyre; (iii) një diskutim më të plotë të alternativave në VNM-në e Projektit. Stafi i Bankës nuk e nxiti Qeverinë e Shqipërisë të këqyrte vendndodhje të tjera të mundshme, krahas vendndodhjes në Vlorë, që ishte tashmë e preferuara, dhe kjo qasje u pranua nga Qeveria në studimin për vendndodhjen dhe studimin e realizueshmërisë.</p> <p>Veprimi: Masa e Ekipit Drejtues në mbështetje të zbatimit të Konventës së Arhusit nga Shqipëria theksohet, më poshtë, në pikën 19.</p>
17.	<p>Bërja Publike e Dokumenteve</p> <p>Dokumentet e mbledhjes së datës 3 shtator 2003 thonë se projekt-VMN u shpërnda më 20 korrik 2003. Por, ky rast i vetëm i njoftimit publik është i pamjaftueshëm për të plotësuar kërkesat e PO 4.01. Në përgjithësi Paneli konstaton se Ekipi Drejtues nuk ka siguruar dhënie publike të informacionit të Projektit palëve të interesuara lokale.</p>	353-355	<p>Koment: Ekipi Drejtues e pranon se termat e referencës për konsultimin e muajit prill 2003 për VNM-në u shpërndanë vetëm gjatë mbledhjes dhe se kjo ishte një e metë. Lidhur me konsultimin e muajit shtator 2003, Ekipi Drejtues vëren se projekt-dokumenti u bë publik në disa lokale, përpara zhvillimit të mbledhjes, dhe se, pas kësaj, janë bërë përditësime në kohë. Ky konsultim u zhvillua dy muaj përpara datës së Vlerësimit të Projektit (10 nëntor 2003) dhe gjashtë muaj përpara prezantimit përpara Bordit. Njoftimi për shtyp për Projektin e miratuar u qarkullua gjerësisht.</p> <p>Ekipi Drejtues beson se periudha e gjatë e bërjes publike të VNM-së së Projektit dhe mbulimi i gjerësishtëm i Projektit të TEC-</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
			<p>it në media, gjatë kohës kur kishte edhe ndërprerje të energjisë elektrike, ofronte një sërë mundësish për palët e interesuara, që këto të fundit të njiheshin me projektin dhe të merrnin dokumentacionin.</p> <p>Veprimi: Mësimet e nxjerra nga gjetjet e Panelit do të inkorporohen në udhëzimet për stafin mbi Politikën mbrojtëse.</p>
18.	<p>Zbatimi i Konsultimeve Publike gjatë gjithë vënies në zbatim të Projektit</p> <p>Paneli konstaton se, përkundër shqetësimit publik në rritje dhe kundërshtimit politik lidhur me Projektin, Ekipi Drejtues nuk siguroi që popullata e zonës së Projektit dhe OJQ-të lokale të konsultoheshin në mënyrë kuptimplote gjatë gjithë përgatitjes dhe vënies në zbatim të Projektit, lidhur me çështjet e lidhura mjedisore, sociale, kulturore, turistike dhe shëndetësore që i prekin. Kjo nuk është në zbatim të PO 4.01 dhe PO/PB 10.04.</p>	356-377	<p>Koment: Ekipi Drejtues vëren se kundërshtimi ndaj zhvillimit të gjerë industrial në Vlorë u shndërrua në moton e njëres prej partive politike, një faktor i cili mund të ketë ndihmuar në rritjen e protestave publike. Kundërshtimi publik ndaj TEC-it lindi rreth dhjetë muaj pas miratimit të Projektit nga Bordi (16 mars 2004), kur disa organizata të shoqërisë civile filluan të mobilizohen kundër zhvillimit industrial në Vlorë, në përgjithësi, dhe, në veçanti, lidhur me terminalin e naftës Petrolifera. E thënë shkurt, kundërshtimi ndaj termocentralit i ndikua nga faktorë që shkonin përtej vetë termocentralit.</p> <p>Ekipi Drejtues vëren se Banka iu është përgjigjur letrave të Kërkuesve dhe palëve të tjera të interesuara në mirëbesim dhe në kohë.</p> <p>Ekipi Drejtues e pranon se këto çështje që dolën pas VNM-së do të ishin administruar më mirë nëse Projekti do të kishte një zë për informim dhe punë afruese me publikun.</p> <p>Veprimi: Ekipi Drejtues vëren se përmirësimi i vlerësimit të efekteve sociale të projekteve është njëra prej masave për Rajonin e EAQ-së, pas shqyrtimit që i bëri Bordi Raportit të Inspektimit për Projektin e Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare në Shqipëri. Ekipi Drejtues do të kujdeset që fuqizimi institucional në këtë aspekt të bëhet edhe për projektet e mëdha të infrastrukturës dhe energjisë.</p> <p>Duke filluar në muajin tetor 2009, Ekipi Drejtues do të vërë në zbatim një Strategji të ndryshuar për Komunikim të Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë, Shqipëri. Ndër të tjera, strategjia e re përfshin: (i) një sistem për përgjigje parapr tëse dhe me afate kohore kundrejt ankesave të ardhura nga komuniteti, shoqëria civile dhe sektori privat; (ii) rritje të mbikëqyrjes së proceseve të konsultimeve të udhëhequra nga qeveria gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve; dhe (iii) seanca vjetore informimi për komisionet përkatëse parlamentare në lidhje me zbatimin e projekteve dhe çështjet e reformave të politikave.</p>
19.	<p>Detyrimet mjedisore ndërkombëtare në bazë të PO 4.01</p> <p>Paneli konstaton se Ekipi Drejtues nuk ka siguruar që veprimtaritë e përgatitjes së Projektit të ishin në përputhje me kërkesat për konsultim dhe pjesëmarrje të publikut të Konventës së Arhusit. Kjo nuk është në zbatim të PO 4.01.</p>	322-332	<p>Koment: Ekipi Drejtues vëren se konstatimet e Panelit mbështeten te konstatimet e Komitetit të Zbatimit të Konventës së Arhusit. Duke qenë se Paneli nuk e ka shprehur bazën për përfundimet e tij lidhur me moszbatimin, në këtë çështje, përveç përmendjes së konstatimeve të Komitetit të Zbatimit të Konventës së Arhusit, ky Raport është përpjekur t'u përgjigjet pikave të ngritura nga Komiteti. Ekipi Drejtues i pranon shqetësimet e Komitetit të Zbatimit të Arhusit lidhur me dokumentimin për ftesat dhe njoftimet për dy konsultimet për VNM-në e Projektit (prill dhe shtator 2003), mirëpo gjithashtu thekson periudhën e gjatë të bërjes publike të dokumenteve të VNM-së, të përmendur më lart, e cila, të paktën, duhet të ketë zbutur disa prej këtyre mangësive të pranuar. Ekipi Drejtues vëren, gjithashtu, se Njoftimi për Shtyp lidhur me miratimin e Projektit nga Bordi u përmend gjerësisht nga mediat kombëtare, e megjithatë kundërshtimi për Projektin doli vetëm pas thujse një viti.</p> <p>Krahas kësaj, në kohën e përgatitjes së Projektit mungonin</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
			<p>orientimet specifike për IFN-të për t'i mbështetur vendet partnere për t'i përbushur detyrimet në kuadër të konventave të UNECE-së (përfshirë edhe Konventën e Arhusit), orientime të cilat ende priten të dalin. Kjo mungesë orientimi praktik është konstatuar si një pengesë për rolin e BERZH-it në mbështetje të Shqipërisë, nga shqyrtimi i Mekanizmit të Shqyrtimit të Brendshëm (prill 2008) lidhur me pjesën e BERZH-it në financimin e TEC-it të Vlorës.</p> <p>Ekipi Drejtues vëren se Banka i është përgjigjur ftesës së Komitetit të Zbatimit të Konventës së Arhusit “<i>për t'i dhënë këshilla dhe asistencë Palës</i>” (domethënë, Shqipërisë) lidhur me përmirësimin e zbatimit të Konventës. Banka ka miratuar një projekt në kuadër të FZHI-së me vlerë 370.000 dollarë amerikanë, në formë granti, për <i>Fuqizimin e Zbatimit të Konventës së Arhusit nga Shqipëria</i>, i cili do të fillojë në shtator 2009 dhe do të mbështetet në punën e ngjashme që ka Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.</p> <p>Objektivat për zhvillim të FZHI-së janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ngritja dhe/ose përmirësimi i kapacitetit të Qendrës së Arhusit, agjencive rajonale mjedisore, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara, për t'i kuptuar kërkesat ligjore të Konventës së Arhusit dhe për të vënë në zbatim strategjinë dhe planin e veprimit të Shqipërisë për Konventën e Arhusit; • Rritja e ndërveprimit midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike lidhur me pjesëmarrjen e publikut dhe lirinë për drejtësi në vendimmarrjen shtetërore lidhur me çështjet mjedisore kombëtare dhe ndërkufitare, duke nxitur zbatimin e përmirësuar të dispozitave përkatëse të Konventës; dhe • Përmirësimi i rolit mbikëqyrës të shoqërisë civile, përmes angazhimit të saj në mënyrë konstruktive në proceset planifikuese të qeverisë të lidhura me mjedisin, përmes monitorimit të përmirësuar të udhëzimeve dhe kërkesave që parashikon Konventa. <p>Krahas këtyre, njëra prej masave për Shqipërinë ishte përmirësimi i kuadrit të saj rregullator mjedisor (domethënë, shtesa, ndryshime dhe plotësime në ligjet mjedisore ekzistuese apo hartimi i ligjeve të reja) për t'i harmonizuar ato me dispozitat e Konventës së Arhusit.</p> <p>Ligji i ri “Për planifikimin e territorit”, i cili është mbështetur nga një sërë donatorësh (Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës, USAID dhe Banka Botërore), si përmes një dialogu për huadhënien e mbështetur të politikave ashtu edhe përmes një projekti investimi, shënon një përparim të ndjeshëm lidhur me mënyrën se si do të administrohet në të ardhmen rregullimi i territorit në Shqipëri. Ky ligj i ri përmban përmirësime të mëdha në fushën e transparencës, dhënies së informacioneve dhe konsultimit me publikun. Ligji e përmirëson ndjeshëm njohëtimin e publikut lidhur me masat planifikuese që po merren në shqyrtim. Një prej elementeve të spikatura të ligjit të ri është krijimi i një “Regjistri Planifikimi” në internet, krahas mjeteve konvencionale të komunikimit, përmes të cilave i jepet informacion publikut. Ligji e krijon regjistrin si vendin ku pushteti vendor, rajonal dhe qendror publikojnë vendimet e propozuara dhe të miratuara të rregullimit të territorit. Këtu përfshihen planet e reja të rregullimit të territorit, kërkesat për leje ndërtimi, miratimet e këtyre lejeve dhe masat kombëtare që lidhen me rregullimin e territorit.</p>

Nr	Çështja / Konstatimi	Nr para.	Komente / Veprime
			<p>Veprimi: Banka do të vijojë mbështetjen për Qeverinë e Shqipërisë në kuadër të projektit të ngritjes së kapaciteteve “Fuqizimi i Zbatimit të Konventës së Arhusit”, mbështetur nga FZHI-ja, i cili do të vazhdojë edhe gjatë gjithë vitit fiskal 2011.</p> <p>Banka do të përgatisë dhe realizojë, në pranverë 2010, një modul trajnimi për stafin e Bankës për asistimin e qeverive partnere që këto të fundit t’i përmbushin detyrimet e tyre në kuadër të traktateve ndërkombëtare, duke përfshirë edhe një modul për zbatimin praktik (me udhëzime me shkrim) të dy Konventave të UNECE-së (Arhusi dhe Espo).</p>
	<p>KËRKESA E DYTË PËR INSPEKTIM PËR PROJEKTIN PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR DHE PASTRIMIN E ZONËS BREGDETARE</p>		
20.	<p>Caktimi i Kufijve të Zonave Bregdetare</p> <p>Paneli vëren se as ndarja e trefishtë e vijës bregdetare shqiptare, as caktimi i kufijve midis tyre, nuk është bërë nga Banka Botërore. Gjatë përdorimit të këtyre ndarjeve në Projektin e saj për Menaxhimin e Zonës Bregdetare, Banka ka ndjekur një praktikë të vendosur që ishte pranuar prej thujse një dekadë nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe, qysh prej vitit 2002, edhe nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë. Paneli nuk konstaton asnjë shkelje të politikave të Bankës, në vendimet e kësaj të fundit për të financuar Projektin e Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare si një projekt më vete në rajonin bregdetar jugor, sikurse është kërkuar nga huamarrësi.</p>	378-397	<p>Koment: Ekipi Drejtues pajtohet me konstatimet e Panelit.</p> <p>Veprimi: Nuk nevojitet asnjë veprim.</p>

ANEKSI 2

MODELIMI I ÇLIRIMEVE ATMOSFERIKE

(Përditësim i Raportit të Ecurisë Mjedisore nga KESH-i, gusht 2009, Rubrika 3 “Cilësia e ajrit”)

Sikurse ia kërkon objekti i punës, “PB Power” ka realizuar një proces të modelimit të shpërhapjes, në emër të KESH-it, për të vlerësuar efektet mjedisore dhe shëndetsore të termocentrali me kapacitet 97 Mwe dhe teknologji CCGT. Ky proces është realizuar në fund të vitit 2007 / fillim të vitit 2008, me informacionin e shpjeguar me hollësi në raportin e fundit të progresit që ka nxjerrë “PBP”.

Modelimi i realizuar ka përfshirë një shqyrtim të çlirimeve të gazeve ndotëse kryesore që do të prodhojë termocentrali gjatë shfrytëzimit normal të tij. Janë parë çlirimet e dioksidit të azotit (NO₂) dioksidit të squfurit (SO₂) dhe grimcave në ajër (PM₁₀) nga centrali dhe efekti i mëpasshëm i shfrytëzimit të centralit në cilësinë e përgjithshme të ajrit në zonën përreth.

Vlerësimi i efektit në cilësinë e ajrit si rezultat i çlirimeve të termocentrali është mbështetur në ndryshimet e parashikuara të përqendrimeve të ndotësve të shqyrtuar në nivelin e sipërfaqes së tokës, krahasuar me standardet evropiane për çlirimet atmosferike, të cilët parashikohen në Direktivën për Cilësinë e Ajrit (Direktiva 99/30/EC).

Gjatë shqyrtimit të efektit të termocentralit të propozuar dhe përqendrimeve të mundshme në nivelin e sipërfaqes së tokës që do të hasen kur të fillojë shfrytëzimi i centralit në 2009, “PBP” mori në konsideratë cilësinë e ajrit në afërsi të vendndodhjes së projektit, të cilën e ka monitoruar KESH-i gjatë periudhës 2004 dhe 2005, për NO₂ dhe SO₂. Janë marrë në konsideratë përqendrimet ndotëse afatgjata dhe afatshkurtra të këtyre ndotësve.

Për modelimin e kryer është ndjekur një këndvështrim konservativ i shfrytëzimit të centralit, në mënyrë që të vlerësohej dhe paraqitej “rasti më i keq”. Rezultati i përdorimit të kësaj qasjeje pesimiste ishte sigurimi që të merrej në konsideratë efekti absolut maksimal i parashkuar brenda regjimit të mundshëm të shfrytëzimit. Kjo ka siguruar që të kishte një “faktor sigurie” brenda vlerësimit të cilësisë së ajrit, duke u dhënë një shkallë të lartë besueshmërie se efektet faktike do të jenë më të vegjël se ata që paraqiten në vlerësim. Për t’u siguruar që në shqyrtim të merrej rasti më i keq, u përdor hipoteza se centrali punon me ngarkesë të plotë gjatë gjithë vitit, çka nuk do të ndodhë në të vërtetë sepse centrali do të punojë gjatë disa periudhave me ngarkesë të reduktuar dhe do të ketë edhe ndërprerje të punës për mirëmbajtje, gjatë të cilave centrali nuk do të jetë në shfrytëzim.

Modelimi i shpërhapjes u bë duke përdorur modelin kompleks të burimeve industriale (ISC-3), i cili është certifikuar edhe nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit (EPA) e SHBA-ve, Agjencia e Mjedisit e Mbretërisë së Bashkuar dhe nga autoritete të shumta mjedisore në mbarë botën.

Të dhënat metodike të përdorura për procesin e modelimit u morën nga stacioni i lëvizshëm në vendndodhje, nga KESH-i. Periudhat e të dhënave që u morën në shqyrtim ishin 2004 dhe 2005. Por, për të mundësuar përdorimin e të dhënave në modelin ISC-3, ishte e nevojshme që të dhënat e mbledhura nga KESH-i të plotësoheshin me të dhëna nga stacioni më i afërt meteorologjik, çka mundëson llogaritjen e klasave të qëndrueshmërisë dhe të lartësive të përzierjes, etj. Stacioni më i afërt meteorologjik ndodhej në Korfuz të Greqisë dhe, për të plotësuar të dhënat e KESH-it, u përdorën të dhënat nga kjo pikë për periudhat 2004 dhe 2005. Për këtë qasje ka dhënë pëlqimin edhe vlerësuesi i pavarur i cilësisë së ajrit i Bankës Botërore, si një qasje e përshtatshme për qëllimet e vlerësimit të modelimit.

Hartet e erës për të dhënat e mbledhura nga KESH-i në 2004 dhe 2005 jepen në Figurën 1 dhe 2, më poshtë.




FIGURA 1
HARTA E ERËS PËR VENDNDODHJEN (2004)




FIGURA 2
HARTA E ERËS PËR VENDNDODHJEN (2005)

Rezultatet e modelimit të kryer u krahasuan me standardet prëkatëse të BE-së dhe Bankës Botërore/KFN-së. U pa se nuk parashikohet që centrali të shkaktonte tejkalim të standardeve të ndryshme për cilësinë e ajrit. Më poshtë jepen rezultatet kyçe

- Mesatarja vjetore e NO₂ e parashikuar për centralin me teknologji CCGT për rastin më të keq ishte 1,8 µg/m³. Kjo është e barabartë me 4,5 për qind të udhëzuesit të BE-së për cilësinë e ajrit, që është 40 µg/m³, maksimumi i të cilit ndodh në 5,3 km në verilindje të termocentralit.
- Në rastin më të keq, përqendrime më të larta në sipërfaqe, për NO₂ parashikoheshin të ishin 32,7 µg/m³ për CCGT. Kjo është e barabartë me 16,3 për qind të udhëzuesit të BE-së, që është 200 µg/m³ ku tymi bie në sipërfaqe rreth 5,3 km në verilindje të termocentralit.
- Rasti më i keq parashikonte përqendrime mesatare vjetore të SO₂ për centralin me vlerë 2,7 µg/m³ të barasvlershme me 3,4 për qind të udhëzuesit të Bankës Botërore (nuk ka udhëzues të BE-së për SO₂ vjetor).
- Vlora orare e 25-të më e lartë për SO₂ e prodhuar nga centrali CCGT ishte 58,2 µg/m³. Kjo është e barabartë me 16,6 për qind të udhëzuesit të BE-së, prej 350 µg/m³. Tymi bie në tokë 5,3 km në verilindje të oxhakut, në një terren malor të papolluar.
- Përqendrimi vjetor i grimcave, për CCGT, u konstatuan jo më shumë se 2,8 µg/m³, më pak se 7 për qind e udhëzuesit të BE-së prej 40 µg/m³, ku maksimumi ndodhej përfaqësisht 7 km në verilindje të termocentralit.
- Përqendrime maksimale të 35 më të larta 24-orëshe në sipërfaqe për PM₁₀ parashikoheshin të ishin vetëm 7,1 µg/m³, ku maksimumi ishte rreth 5,3 km në verilindje të termocentralit. Kjo vlerë përfaqëson më pak se 14,2 për qind të udhëzuesit të BE-së prej 50 µg/m³.
- Në të gjitha rastet, edhe kur skenarit më të keq të modelit i shtohet cilësia e ajrit, e regjistruar nga KESH-i në afërsi të centralit të Vlorës, përsëri nuk u afrohet kufijve të lejueshëm të udhëzimeve të BE-së për cilësinë e ajrit.

Modelimi i rastit të dytë, me tri njësi CCGT siç e kërkonte objekti i parë i punës, përsëri tregon se centrali do të shfrytëzohej brenda kërkesave ligjore të Direktivës së BE-së për Cilësinë e Ajrit, edhe kur parashikimeve të modelit u shtohen përqendrime maksimale më të këqija të regjistruara nga KESH-i.

U arrit në përfundimin se as shfrytëzimi i një CCGT të vetëm as i një centrali me tri njësi nuk do të sillte, i vetëm, tejkalim të udhëzuesve përkatës, ku vlerat maksimale ndodhin në malet përgjithësisht të pabanuar, në verilindje të termocentralit.

ANEKSI 3
FOTOGRAFITË

Foto 1. TEC-i nga Gjiri i Vlorës

Foto 2. TEC-i, brenda objektit

Foto 3. Linja e re transmetimit

Foto 4. Stacioni i monitorimit të vazhdueshëm të ajrit, pranë oxhakut

Foto 5. Rezultat në stacionin e monitorimit të ajrit, në sallën operatore (shembull, sepse nuk ka filluar ende shfrytëzimi i centralit)

Foto 6. Stacioni i lëvizshëm i monitorimit të ajrit; të dhënat e përdorura për të kalibruar modelimin

Foto 7. Kufizimi i rrjedhjeve rreth depozitave të naftës

Foto 8. Lidhja e naftës-jellësit te centrali (valvolat dhe kufizimi i rrjedhjeve në bazë)

Foto 9. Platformë e re pluskuese për të siguruar depozitat gjatë shkarkimit të lëndës djegëse; në largësi, shihet centrali

Foto 10. Terminali i vjetër i naftës (nuk është pjesë e projektit)

Foto 11. Plazh i qytetit të Vlorës (në veri të qendrës së qytetit) në një të dielë të nxehtë

Foto 12. Plazh i qytetit të Vlorës (në veri të qendrës së qytetit); disa shqetësime për cilësinë e ujit dhe mirëmbajtjen

Foto 13. Plazh i qytetit të Vlorës (më në veri, në drejtim të sodës kaustike)

Foto 14. Porti i peshkimit, ngjitur me TEC-in

Foto 15. Terminali i trageteve në qytetin e Vlorës

Foto 16. Plazh në jug të qendrës së Vlorës

Foto 17. Zonë bregdetare në jug të Vlorës, në anën tjetër të Gadishullit të Karaburunit